



ВИСОКА ШКОЛА ЗА НОВИНАРСТВО
И ЗА ОДНОСИ СО ЈАВНОСТА



SHKRIM-LEXIMI MEDIATIK NË MAQEDONI: PËRPJEKJE PËR IMPLEMENTIM NË ARSIMIN FILLOR

Hulumtimi është pjesë nga projekti
„Shkrim-leximi mediatic në erën e prurjes së informacioneve: Koalicioni për shkrim-lexim mediatic“
i financuar nga Unioni Evropian

www.medium.edu.mk

**Shkrim-leximi mediatik
në Maqedoni:
PËRPJEKJE PËR IMPLEMENTIM
NË ARSIMIN FILLOR**



**ВИСОКА ШКОЛА ЗА НОВИНАРСТВО
И ЗА ОДНОСИ СО ЈАВНОСТА**

Shkup, 2018

Botues: Shkolla e lartë për gazetari dhe për marrëdhënie me opinionin
Për botuesin: Zhaneta Trajkoska
Editimi: ResPublika

Autorë: Vesna Shopar, Aleksandra Temenugova, Monika Aksentievaska
Redaktor: Zhaneta Trajkoska
Bashkëpunëtor profesional: Bllaga Paneva, Byroja për zhvillim të arsimit
Lektor: Tatjana B. Eftimovska
Dizajn dhe përpunim teknik: Dejan Joveski
Fotografia në faqen e parë: Maja Janevska-llieva
Shtypshkronja: Vinsent Grafika Shkup
Tirazh: 100
Viti i publikimit: 2018



Përpunimi dhe shtypja e publikimit “Doracak për shkrim-leximin mediatik për të rinj, për medie dhe organizata civile” është e mundësuar na Unioni Evropian në kuadër të Projektit “Shkrim-leximi mediatik në erën e prurjes së informacioneve: themelimi i koalicionit për shkrim-lexim mediatik” që e realizoi Shkolla e lartë për gazetari dhe për raporte me opinionin në bashkëpunim me Institutin për dallime në mediet nga Londra, Britania e Madhe dhe me gazetën ditore “Nova Makedonija”. Mendimet e theksuara të këtij publikimi janë mendime të autorëve dhe nuk i reflektojnë gjithmonë mendimet e Unionit Evropian



CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.015:316.774(497.7)(047.31)

SHOPAR, Vesna

Shkrim-leximi mediatik në Maqedoni : Përpjekje për implementim në arsimin fillor / [autorë Vesna Shopar, Aleksandra Temenugova, Monika Aksentievaska]. - Скопје : Висока школа за новинарство и за односи со јавноста, Институт за комуникациски студии, 2018. - 74 стр. ; 30 см. - (Editimi ResPublika)

Публикацијата е во рамки на проектот: „Shkrim-leximi mediatik në erën e prurjes së informacioneve: themelimi i koalicionit për shkrim-lexim mediatik“. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 67-74

ISBN 978-608-4805-08-3

1. Temenugova, Aleksandra [автор] 2. Aksentievaska, Monika [автор]
а) Медиумска писменост - Основно образование - Македонија - Истражувања
COBISS.MK-ID 109145354

Përmbajtje

Hyrje.....	6
1. Edukimi për shkrim-lexim mediatik.....	9
2. Standarde dhe dokumente ndërkombëtare dhe evropiane.....	15
3. Praktikimi i edukimit mediatik – shembulli i Sllovenisë.....	25
4. Rregullativa për edukim mediatik në Maqedoni.....	37
5. Shkrim-leximi mediatik në programet mësimore në arsimin fillor në Maqedoni.....	43
Konkluzë.....	59
rekomandime.....	63
Bibliografi.....	67

Hyrje

Raporti hulumtues “Shkrim-leximi mediatik – përpjekje për implementim në arsimin fillor” është vazhdimi i hulumtimi “Shkrim – leximi mediatik në Maqedoni: mjet që mungon për qytetari aktive” nga viti 2016, kur Shkolla e lartë për gazetari dhe për marrëdhënie me opinionin e analizo shkrim-leximin mediatik në arsimin e mesëm, në sektorin civil dhe te mediet.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të konstatohet gjendja në implementimin e shkrim-leximit mediatik në arsimin fillor në Maqedoni. Në analizën definohe arsimi mediatik si proces dhe shkrim-leximi mediatik si rezultat i atij procesi. Shpjegohet koncepti i edukimit mediatik sipas standardeve dhe dokumenteve ndërkombëtare dhe evropiane, modelet e ndryshme të praktikumit të edukimit mediatik, ndërsa në mënyrë të posaçme është analizuar modeli sloven i edukimit mediatik.

Çështje kyç që parashtrohen në dokumentin janë: si trajtohet shkrim-leximi mediatik në planet dhe programet arsimore, çfarë aftësi përfitojnë nga sfera e shkrim-leximit mediatik, cilat forma të përfitimit të diturive për shkrim-lexim mediatik përdoren (materiale didaktike, pajisje, kushte hapësinore, aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore), dhe çfarë është edukimi i kuadrit arsimor për shkrim-lexim mediatik.

Qasja mediatike bazohet mbi analizën e dokumenteve ndërkombëtare, rregullativës së vendit dhe asaj ndërkombëtare për politikë arsimore, grupe të fokusit me arsimtarë nga të tetë rajonet planore në Maqedoni (Lindor, Verilindor, të Pollogut, të Pellagonisë, të Shkupit, Juglindor, Juperëndimor dhe Rajoni i Vardarit) dhe intervista me përfaqësues të Byrosë për arsim, Ministrisë së arsimit dhe të shkencës, fakultetet pedagogjike në vend, organizata civile, medie dhe Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale, Byroja për zhvillim të arsimit në MASH e ndihmoi procesin hulumtues me organizimin e fokus-grupeve me arsimtarët, librat mësimore, ndërsa kishte edhe rol konsultativ në analizën e programeve mësimore. Hulumtimi dhe analizimi i të dhënave të grumbulluara u realizua nga qershori deri në dhjetor të vitit 2018.

Hulumtimi është pjesë e projektit “Shkrim-leximi mediatik në shekullin e vërshimit të informacioneve: krijimi i koalicionit për shkrim-lexim mediatik dhe informatik”, që e udhëheq Shkolla e lartë për gazetari dhe për raporte me opinionin, ekipi i të cilit e realizoi edhe këtë hulumtim. Projekti është i financuar nga Unioni Evropian.

1.

Edukimi për shkrim-leximin mediatik

**No child's education is complete without media literacy
education and skills of the 21st century literacies.
(Wan and Gut, 2008)**

Sot në botën e radios, televizionit, kompjuterëve dhe të internetit, thuhet se këto janë mjete tona dominante kulturore për kërkim, seleksionim, grumbullim, depozitim dhe transmetim të diturive. Tanimë nuk bëhet dallim midis medieve tradicionale dhe digjitale dhe mund të lexohet gazetë, të shihet televizion dhe film në kompjuter ose në telefon celular. Por, rritja e diturisë me përdorimin e medieve masive dhe të komunikimeve i ka edhe avantazhet dhe mangësitë e veta. Përderisa i marrim anët e tyre të mira, duhet të bëjmë përpjekje që ti shmangim anët negative. Prandaj na nevojitet zhvillimi i shkrim-leximit mediatic, posaçërisht tek fëmijët, popullatë e lindur dhe e rritur me teknologjitë e reja informatike-komunikuese, të pranishme në shtëpi ashtu edhe në shkollë.

Për shkrim-lexim mediatic na nevojitet edukim mediatic. Vetë nocioni shkrim-lexim mediatic është i definuar që në vitin 1992 në Konferencën për shkrim-lexim mediatic (National Leadership Conference on Media Literacy) në Aspen, Amerikë, ndërsa në teorinë edhe sot ekziston konsensus për rëndësinë e tij si *“aftësi për qasje, analizë, evaluim dhe komunikim të informacioneve në të gjitha format e tyre”* (Aufderheide, 1993:6). Ai zhvillon zhvillim të shkathtësive të ndryshme: teknike (aftësi për qasje në mediet), kritike (kuptimi i përmbajtjeve mediatiche, aftësi për shpjegimin dhe vlerësim të tyre), praktike (aftësi për krijimin e mesazheve mediatiche). Madje, mund të thuhet se në bazamentin e saj është parimi i hulumtimit. Më vonë, Karta Evropiane për shkrim-lexim mediatic do të ofrojë definicion më të gjerë për të përfshirë të gjitha elementet e mundshme të shkrim-leximit mediatic. Ajo përfshin: *“Përdorim efikas të teknologjive mediatiche për qasje, ruajtje, marrje të sërishme dhe shpërndarje të përmbajtjes për përmbushjen e nevojave dhe të interesave të individit dhe të bashkësisë; mundësim të qasjes deri, madje edhe zgjedhje e vetëdijshme, të spektri i gjerë të formave dhe përmbajtjeve mediatiche nga burimet e ndryshme kulturore dhe institucionale; të kuptohet se si dhe përse prodhohet përmbajtja mediatiche; analizë kritike e teknikave, gjuhës dhe konvencioneve që i përdorin mediet dhe mesazhet që i transmetojnë; përdorimi kreativ i medias për shprehjen dhe përcjelljen e ideve, informacioneve dhe opinioneve; identifikim dhe shmangie ose kundërshtim të përmbajtjeve dhe shërbimeve të medias të cilat mund të jenë të padëshiruara, ofenduese ose të dëmshme; përdorimi efektiv i medieve në realizimin e të drejtave demokratike dhe përgjegjësive qytetare.”* (Bachmair, Bazalgette, 2007:84)

Nga ana tjetër, duke e ndjekur Rekomandimin për edukimin mediatic të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (nga viti 2000), edukimi mediatic është i definuar si *“Praktika të mësimdhënies që këmbëngulin të zhvillojnë kompetenca mediatiche, që kuptohen si një qëndrim kritik dhe racional ndaj medieve, e me qëllim të ndërtimit të qytetarëve mirë të balancuar për ta sjellë gjykimin e vet në bazë të informacionit në dispozicion. Kjo ju mundëson qasje në informacionet e nevojshme, analizë dhe identifikim të interesave ekonomikë, politikë, socialë dhe/ose kulturorë*

të cilat qëndrojnë pas tyre. Edukimi mediatic i mëson individët të interpretojnë dhe prodhojnë mesazhe, të zgjedhin medium më të përshtatshëm për komunikim dhe të kenë një ndikim më të madh në ofertën dhe produksionin mediatic.”¹ Pra, edukimi mediatic merret me mësimdhënie dhe të mësuarin për mediet, e jo mësim përmes medieeve dhe përdorimin e tyre në orët si mjet mësimor. Ai mbulon një gamë të gjerë të medieeve, duke e përfshirë filmin, televizionin, videon, radion, mediet të shtypura (posaçërisht gazetatat dhe revistat) dhe teknologjitë e reja të komunikimit digjital në kontekstin shoqëroro-politik, produksionin dhe shpërndarjen e informacionit, rritjen e industrisë së medias, zhvillimin e medieeve komerciale, rolin e reklamimit... Qëllimi është të përfitohet njohuri nga të rinjtë për të kuptuarin e karakteristikave, nevojave dhe problemeve të medieeve, zhvillimi i aftësive për analizë kritike, vlerësim dhe interpretim të përmbajtjes, formatin dhe kontekstin e rekomandimeve mediatiche, si dhe aftësi për përdorim të mjeteve digjitale, vizuale dhe elektronike për krijimin e mesazheve të veta për komunikim dhe prezantim (Buckingham, 2001).

Në fakt, bëhet fjalë për një bashkim midis edukimit (mediatic) si proces nga shkrim-leximi (mediatike) si rezultat i atij procesi. Pikërisht për këtë, sot për nga ana terminologjike është bërë e zakonshme të flitet për *“edukim për shkrim-lexim mediatic”* (media literacy education). Përkatësisht, për të pasur shkrim-lexim mediatic në shekullin e 21-të do të thotë të jesh i vetëdijshëm për ndikuesin e medieeve mbi individin dhe shoqërinë, të kuptuarit e procesit të komunikimit masiv, aftësi për analizë dhe diskutim për përmbajtjet mediatiche dhe kontekstin e tyre, zhvillimi i strategjive për analizë kritike të medieeve, pavarësia nga ndikimi i medieeve dhe mendje të hapur për pranim dhe eksperimentim me mjetet e reja për edukim dhe mësim që i ofron shekulli informatik. Pjesa më e madhe e publikut akademik pajtohet se njohuritë mediatiche varen si nga dituria, ashtu edhe nga aftësitë. Individu patjetër duhet të ketë dituri për mediet masive dhe natyrën e tyre, por në të njëjtën kohë të jetë i aftë ta përdor atë dituri kur qaset, analizon ose vlerëson përmbajtje të ndryshme mediatiche. Procesi i të mësuarit të shkrim-leximit mediatic përfshin një spektër të gjerë të nxënësve, preferencat e tyre individuale, interesat e tyre reale, kreativitetin, respektin e ndërsjellë. Ai nuk përfshin vetëm lexim dhe perceptim, por edhe punë, përvojë, eksperimentim dhe mirëkuptimin. Këtu nxënësi krijon, prodhon dhe i kupton informacionet nëpërmjet përvojës së tij personale, interpretimit, imagjinatës dhe punës. Ndër të tjerat, me atë e rrit dhe fuqizon të kuptuarin e vetvetes, si një parakusht për përshtatjen në botën globale dhe funksionimin si një qytetar aktiv në shoqëri. (Kupiainen, Reijo & Sintonen, 2010).

Natyrisht, edukimi mediatic dhe shkrim-leximi mediatic nuk janë dhe nuk mund të jenë “mbrojtje” e fëmijëve nga mesazhet e padëshiruara të medias. Megjithatë ka shumë që i ftojnë familjet, për shembull, që ta shkyçin televizorin ose fëmijëve t’ua kufizojnë kohën për përdorimin e kompjuterit, është fakt se mediet janë caq të rrënjësura në mjedisin tonë kulturor që ato bëhen pjesë e kulturës sonë. Prandaj, shkrim-leximi mediatic duhet t’ju ndihmojë nxënësve që të bëhen kompetent, me njohuri kritike në të gjitha format mediatiche, ashtu që do ta kontrollojnë shpjegimin

1 Shih: Council of Europe: Recommendation 1466 (2000) Media Education, <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=16811&lang=en>

e asaj që ata e shohin ose dëgjojnë, në vend që të lejojnë që shpjegimi ti kontrollojë ata. Për tu bërë me shkrim-lexim mediatik nuk mjafton të mbahen faktet ose statistikat për mediet, por të mësohet të parashtrahet pyetja e vërtetë për atë që shihet, lexohet ose dëgjohet. Len Masterman (Len Masterman), njeriu i parë që propozoi një studim serioz të medieeve masive në shkollat dhe u bë sensacion ndërkombëtar me publikimin e librit “Mësimdhënia për televizionin” (Teaching about Television) në vitin 1980, këtë e emërton “autonomi kritike” ose aftësi të mendojë për vetveten. Pa këtë aftësi themelore, individit nuk mund të ketë dinjitet të plotë si personalitet njerëzor ose të praktikojë qytetari në një shoqëri demokratike ku të jesh një qytetar në të njëjtën kohë është që të kuptohet dhe të kontribuohet në debatet e kohës aktuale. (Thoman, Jolls, 2003:21)

Gjithashtu, edukimi mediatik dhe shkrim-leximi mediatik nuk mund të trajtohen as si një ilaç për përmbajtje të ndryshme manipuluese, megjithëse në momentin e tanishëm, pikërisht shkrim-leximi mediatik është bërë një qendër graviteti në luftën kundër “lajmeve të rremë” që e kanë vërshuar të gjithë botën dhe i ngritën në këmbë edukatorët, ligjvënësit, filantropët dhe teknologët. Pikërisht për këtë shkak, është edhe më alarmuese nevoja për edukimin mediatik të fëmijëve dhe fuqizimi, para së gjithash, të aftësive kritike dhe të bërjes së dallimit gjatë pranimit të përmbajtjeve mediatike. Përkatësisht, nëse një nga qëllimet e edukimit mediatik është që të zhvillojë individë autonome dhe kritikë me fuqinë për t’i rezistuar manipulimeve dhe retorikës së medieeve, nuk duhet të harrohet edhe “audiencia aktive” gjë e cila sugjeron se domethënia e teksteve mediatike nuk është vetëm mesazh i dërguar te publiku, por gjithashtu se edhe ajo është krijuesi i saj. Ajo, me përdorimin e video kamerave dhe të pajisjes tjetër mediatike, lirshëm i krijon domethëniet e veta dhe prezantimet e veta mediatike. Fokusi është i ri-drejtuar në teknologjinë digjitale, lojërat dhe internetin, ndërsa mediet e reja digjitale (të pasura me fotografi, tekst, tingull, video, animacione) të cilat kërkojnë edhe kompetenca të reja. Përkatësisht, “ardhmëria e zhvillimit të shkrim-leximit mediatik duhet të përfshijë zhvillim të shkathtësive tradicionale për shkrim dhe lexim në kombinim me praktikën e reja të njohurive të cilat e përfshijnë të folurin, të shikuarin, dëgjimin dhe dizajnimin” (Thomas, Jolls, 2003:21)

Sa i përket kohës **“përralla” – edukimi për shkrim-lexim mediatik** ka filluar në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar kur theksi vëhet në zvogëlimin dhe pengimin e ndikimit negativ të medieeve, para së gjithash, të filmit dhe të televizionit.² Por, me kalimin kohës, fokusi i mbrojtjes zhvendoset ndaj raportit aktiv dhe të përgjegjshëm dhe edukimit mediatik, dhe vëmendje gjithnjë e më e madhe i kushtohet aftësive komunikuese të fëmijëve, përkatësisht zhvillimit të diturive dhe shkathtësive të nevojshme për përdorim të sigurt të medieeve, por edhe të kuptuarin kritik të përmbajtjeve të medieeve dhe mënyrën e funksionimit të vetë medieeve. Sot vëmendje e posaçme i kushtohet internetit (shkrim-leximit për internetin), promovimit të përdorimit të sigurt të internetit përmes zhdukjes së përmbajtjeve ilegale, të dëmshme dhe lajmeve të rreme. Për nga ana kronologjike, edukimi mediatik fillimisht zhvillohet në Britaninë e Madhe, Australinë, Kanadanë, Afrikën Jugore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Australia

² Para së gjithash, Konventa për televizion tej-kufitar e Këshillit të Evropës dhe Direktiva për shërbime audiovizuale mediatike të Unionit Evropian me të cilën rregullohet emetimi i përmbajtjeve të cilat nuk janë të dedikuara për publikun më të gjerë.

midis të parëve do të formojë studime për shkrim-lexim mediatik, ndërsa tekstet e para për këtë janë përgatitur gjatë viteve të 80-ta dhe 90-ta. Mandej interesi rritet edhe në vende të tjera, si Holandë, Rusi dhe Itali. Sot, nuk ka vend anëtar të Unionit Evropian në të cilin edukimi për shkrim-lexim mediatik nuk është i pranishëm në sistemet arsimore, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për lëndë të veçantë ose për qasje inter/kulikulare në programe të ndryshme.

Në fakt, rruga drejt hyrjes së edukimit mediatik në sistemin arsimor të vendeve të shumta në botë do ta trasojë UNESCO në vitin 1982 me Deklaratën mbi edukimin mediatik në Grunvald, Gjermani. Deklarata e thekson praninë e përgjithshme të medieve dhe ndikimin e tyre të madh, por edhe faktin se ato janë pjesë e kulturës së botës së sotme dhe instrument për pjesëmarrje aktive qytetare në shoqërinë. Gjithashtu, theksohet se numri më i madh i sistemeve për arsim formal dhe joformal nuk nxisin edukim mediatik, ndërsa shkollat dhe prindërit e ndajnë përgjegjësinë për përgatitje të rinjve për jetë në botën me fotografi, fjalë ose tinguj të fuqishëm. Përkrahjet një qasje e integruar në mësimin e gjuhës dhe të komunikimit, dhe theksohet se edukimi mediatik do të jetë i suksesshëm nëse prindërit, mësimitdhënësit, punëtorët mediatik dhe bartësit e vendimeve e dallojnë rolin e vet në atë proces. Integrimi më i madh i edukimit mediatik në mësimin do të ishte një hap i rëndësishëm drejt edukimit më efektiv.

2.

Standarde dhe dokumente ndërkombëtare dhe evropiane

UNESKO: Koncepti për arsim mediatik. Një nga dokumentet më të rëndësishme, aktual edhe sot, në sferën e arsimit mediatik, gjithsesi është *Deklarata për arsim mediatik* (Grunwald Declaration on Media Education¹) të cilën UNESCO në vitin 1982 do ta miratojë në Simpoziumin Ndërkombëtar në Grunwald, Gjermani. Në atë theksohet nevoja për formë koherente dhe sistematike të edukimit të medieeve masive si parakusht për qytetarinë bashkëkohore. Në atë drejtim, organet kompetente në shtetet ftohen:

- (1) *Të iniciojnë dhe përkrahin programe gjithëpërfshirëse, nga niveli parashkollor deri në atë universitar edhe në arsimin për moshën, qëllimi i të cilave është zhvillimi i diturive, shkathtësive dhe të qëndrimeve të cilat do ta nxisin nivelin e vetëdijes kritike dhe kompetencën më të madhe midis shfrytëzuesve të medieeve elektronike dhe të shtypura. Në mënyrë ideale, programet e tilla duhet të përfshijnë analizë të produkteve mediatike, përdorimin e medieeve si mjet për shprehje kreative dhe përdorim efikas dhe pjesëmarrje në kanalet e medias në dispozicion,*
- (2) *Të zhvillohen kurse për arsimtarë dhe ndërmjetës dhe të rritet njohuria dhe i të kuptuarit të tyre për mediet dhe ata të trajnohen në metodat përkatëse arsimore, duke marrë parasysh me këtë rast njohurinë e konsiderueshme, por fragmentare me mediet të cilën tashmë e posedojnë shumë nxënës,*
- (3) *Ti nxisin aktivitetet hulumtuese dhe zhvillimore në interes të edukimit mediatik, nga sfera e psikologjisë, sociologjisë dhe shkencave të komunikimit, dhe*
- (4) *Të japin përkrahje dhe fuqizim të aktiviteteve që janë ndërmarrë ose parashikuar nga UNESCO, qëllimi i të cilave është nxitje e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e edukimit mediatik.*

Mandej do të vijojnë konferenca të tjera të shumta me zgjerimin, saktësimin dhe zhvillimin e konceptit, teorisë dhe praktikës të edukimit mediatik. Kështu, në vitin 1990 në Tuluz, Francë, në Konferencën *“Drejtime të reja në edukimin mediatik”* (New Directions in Media Education), është saktësuar koncepti i shkrim-leximit mediatik si *“dituri për strukturën, ekonominë dhe funksionet e sistemit të medieeve masovike në shoqërinë si dhe shkathtësitë analitike për leximin edhe të përmbajtjeve ideologjike të mesazheve të medieeve masovike”* (Thoman, 2000). Është konstatuar se, shoqëria bashkëkohore nga era e shkrim-leximit linguistik ka kaluar në erën e shkrim-leximit elektronik dhe mu për këtë shkak shkrim-leximi mediatik nuk është luks por domosdoshmëri. Ajo që është më e rëndësishme, ndryshon perceptimi i rolit të konsumuesve të medieeve. Nëse në vitet e 50-ta dhe 60-ta në ata shihej si në *“tabula rasa”*, tanimë ata po bëhen krijues aktivë të kuptimeve dhe çështja më nuk është se çka bëjnë mediet me njerëzit por çka bëjnë njerëzit me mediet. Përkatësisht, qëllimi është që qytetarët të aftësohen për raport aktiv me medien në vend të mbrojtjes së tyre nga ndikimi i dëmshëm potencial i medieeve masive (përmes ndërmjetësimit të ideologjisë, komercializimit

1 Shih: http://www.unesco.org/education/pdf/MEDIA_E.PDF

mit, shpalljeve të paguara dhe përmbajtjeve me vlera të ulëta estetike dhe edukative). Si elemente të nevojshme për zhvillimin e edukimit mediatic theksohen: a) vendosje të udhëzimeve për programe arsimore (në nivel kombëtar ose rajonal) të institucioneve përkatëse arsimore, b) programe për trajnim të arsimtarëve në nivel universitar (jo programe për gazetari, por arsim me specializim specifik), v) mbështetje e mësimdhënësve - programe edukative gjatë punës, kurse verore etj. përmes të cilave mësimdhënësit do të avancojnë në specializimin e zgjedhur, g) burime arsimore për mësimdhënie - tekste, plane mësimore, lista të aktiviteteve, video, postera, broshura të nevojshme për mësimin.

Në Konferencën “*Arsimi për medie dhe koha digjitale*” (Educating for the Media and the Digital Age) të mbajtur në vitin 1999 në Vjenë, Austri, theksohet edukimi mediatic si pjesë e të drejtave themelore të çdo qytetari në çdo vend të botës, të lirisë të shprehjes dhe e drejta e informimit dhe rolit të tij në ndërtimin dhe kultivimin e demokracisë. Në atë kontekst, mësimi mediatic: a) ka të bëjë me të gjitha mediet e komunikimit dhe e përfshin fjalën e shkruar dhe grafikën, tingullin, fotografitë e palëvizshme dhe filmin pavarësisht nga teknologjia e transmetimit, b) ju mundëson njerëzve që të përfitojnë se si ti kuptojnë mediet e komunikimit që përdoren në shoqërinë dhe mënyrën në të cilën ato punojnë, si dhe të fitojnë shkathtësi për përdorim të këtyre medieve për të komunikuar me të tjerët, v) siguron që njerëzit të mësojnë se si të analizojnë, të mendojnë në mënyrë kritike dhe të krijojnë tekste mediaticke, ti identifikojnë burimet e teksteve mediaticke, interesat e tyre politike, sociale, komerciale dhe/ose kulturore dhe kontekstin e tyre, ti interpretojnë mesazhet dhe vlerat që i ofrojnë mediet, të zgjedhin medie përkatëse për komunikim të mesazheve ose rrefimeve të veta për të depërtuar deri te publiku i dëshiruar, të përfitojnë ose të kërkojnë qasje në mediet me qëllim të pranimit dhe të prodhimit.² Me këtë rast, rekomandohet që përfshirja e edukimit mediatic të zgjerohet në planet mësimore çdokund ku kjo është e mundur (jo vetëm në kuadër të gjuhës), si dhe të jetë pjesë e të mësuarit deri në fund të jetës. Për herë të parë përmendet nevoja për qasje në teknologjitë elektronike dhe digjitale për personat me aftësi të kufizuara dhe ato në një situatë të vështirë sociale dhe ekonomike, si dhe roli i veçantë arsimit mediatic në situata specifike siç janë konfliktet sociale dhe politike, luftërat, katastrofat natyrore dhe ekologjike.

Tubimi në Paris në vitin 2007 do ta konfirmojë rëndësinë e Deklaratës së Grunvaldit të vitit 1982, e madje do ta vlerësojë si shumë më të rëndësishme 25 vjet pas ndodhjes së saj. Në tubimin do të theksohet se ajo që është thënë atëherë, ashpërsohet sot në kohën e shoqërisë informatike dhe përhapjes së diturive në kontekst global. Vendi dhe roli i medieve në shoqëritë tona është gjithnjë e më i madh, ndërsa qytetarët, shumë më tepër së kurrë më parë, patjetër duhet të kenë aftësi për analizë kritike të përmbajtjes pa marrë parasysh të sistemit të simboleve që përdoret (fotografi, tingull, tekst) për t’iu adaptuar ndryshimeve sociale. Si rrjedhojë, e nevojshme dhe urgjente është nevoja për mobilizim ndërkombëtar për rritje të edukimit mediatic dhe përfshirje

² Shih: Recommendations addressed to UNESCO Adopted by the Vienna Conference „Educating for the Media and the Digital Age“, 1999, Available at: <http://www.nordicom.gu.se/en/clearinghouse/recommendations-addressed-unesco-media-education>

në procesin e të gjitha palëve të interesuara. Nga tubimi do të burojnë 12 rekomandime për katër aktivitete prioritare: zhvillimi i konceptit i edukimit gjithëpërfshirës mediatik në të gjitha nivelet arsimore, trajnimi i mësimitdhënësve dhe ngritje e vetëdijes të palëve të tjera të prekura në sferën sociale, hulumtimin dhe përhapjen e tyre në rrjet, bashkëpunimin ndërkombëtar. Në këtë kontekst posaçërisht të rëndësishme duken dy të parat (me 8 rekomandime). Ato përfshijnë:

1. *Miratimin i një definicioni inkluziv për edukimin mediatik me tre qëllime kryesore – qasje në të gjitha llojet e medieve të cilat janë mjete potenciale për ta kuptuar shoqërinë dhe për pjesëmarrje në jetën demokratike, zhvillim i shkathtësive për analizë kritike të mesazheve qofshin ato informative ose zbavitëse, nxitje të produktivitetit, kreativitetit dhe ndërveprimit në fushat e ndryshme e medieve,*

2. *Forcimin e lidhjeve midis arsimit mediatik, llojllojshmërisë kulturore dhe respektimit të të drejtave të njeriut me përshtatje të programeve mësimore të llojllojshmërisë së kontekstit kulturor, arsimor, social dhe ekonomik,*

3. *Definimi i shkathtësive themelore dhe të sistemeve për vlerësim.* Ato kanë karakter interdisiplinar dhe duhet të theksohen për çdo nivel të sistemit arsimor. Vlerësimi i tyre duhet ti marrë parasysh nxënësit, si dhe mësimitdhënësit në trajnimin dhe duhet të ndihmojë në përmirësimin e relevancës dhe efektivitetit të planeve mësimore për edukim mediatik.

4. *Integrimi i edukimit mediatik në trajnimin fillestar të mësimitdhënësve.* Ky element kyç i sistemit dhe patjetër duhet të përfshijë dimensione teorike dhe shkathtësi praktike, të mbështetet në njohje të mirë të nevojave mediatike të njerëzve të rinj. Në kohën e ndryshimeve të shpejta, ky trajnim patjetër duhet të mbështetet në aktivitete institucionale dhe vetë-trajnim, duke shfrytëzuar mjete ndihmëse arsimore të cilat kanë qenë të testuara nga arsimtarët dhe nxënësit.

5. *Zhvillim i metodave përkatëse dhe të avancuara zhvillimore pedagogjike.* Qëllimi kryesor është që të vendosen metoda të reja “aktive” të cilat nuk janë kompatible me recetat tanimë të përgatitura për ligjërime si dhe evolucioni i rolit të mësimitdhënësit dhe pjesëmarrje më të madhe të nxënësve.

6. *Mobilizimi i të gjithë pjesëmarrësve në sistemin arsimor.* Integrimi i edukimit mediatik patjetër duhet ti mobilizojë të gjitha palët e involvuara. Duhet të rritet vetëdija për menaxherët e programeve edukative, drejtorët e shkollave, nëpunësit kryesor arsimor që të marrin përgjegjësi për legjitimim të këtyre aksioneve.

7. *Mobilizimi i palëve të tjera të prekura në sferën sociale.* Edukimi mediatik nuk mund të kufizohet në mjedisin shkollor, ajo është brengë edhe e familjeve, asociacioneve dhe profesionistëve mediatik. edukimi mediatik duhet të integrohet në trajnimin profesional të gazetarëve dhe të përfshijë persona juridik dhe dituri etike. E njëjta vlen edhe për të gjithë profesionistët mediatik, prodhues të përmbajtjeve, redaktorë, radiodifuzerë e kështu me radhë.

8. *Vendosja e dukimit mediatik në kuadër të të mësuarit të përgjeshëm.* Edukimi mediatik nuk është vetëm për të rinjtë, por edhe për të rriturit, informacionet dhe burimet e të cilëve kryesor të diturisë janë mediet. Në këtë kontekst, edukimi mediatik është një proces cilësor i të mësuarit gjatë gjithë jetës. Të rriturve duhet tu sigurohet trajnim i cili do tu ndihmojë të bëhen qytetarë më të lirë dhe më aktivë në shoqëri. Trajnimi i vazhdueshëm duhet të zhvillohet në nivel lokal me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, organizatave joqeveritare dhe të ekspertëve.³

Disa vite më vonë, ndërsa pas një periudhë më të gjatë të përsosjes, punës dhe të bashkëpunimit me shkencëtarë, arsimtarë, akademikë, arsimtarë të shquar të shumtë, UNESCO në vitin 2011 e botoi publikimin *“Kurikulë për shkrim-lexim mediatik dhe informatik për mësime të mësimdhënës”* (Media and Information Literacy Curriculum for Teachers) duke siguruar instrument praktik si ndihmë për qeveritë që ti realizojnë qëllimet e Grunvallit Deklaratës për shkrim-lexim dhe arsim duke e marrë parasysh zhvillimin aktual të teknologjive informatike dhe të komunikimit dhe konvergencë të medieve. Tanimë nga viti i ardhshëm do të iniciojë mbajtje të rregullt të javës botërore të shkrim-leximit mediatik dhe informatik.⁴

Unioni Evropian – Aktivitete dhe drejtime për edukim mediatik. Deri më tani në kuadër të trupave të Bashkimit Evropian janë lëshuar më tepër dokumente strategjike dhe rekomandime për përfshirje më intensive të shkrim-leximit mediatik në sfera të shumta si industria dhe tregu digjital, organet rregullatore të medias, ekonomia dhe zhvillimi i teknologjisë digjitale dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Që nga viti 1989 Direktiva për televizion tejkufitar i Parlamentit Evropian të Parlamentit Evropian, e cila, mes të tjerave, i rregullon parimet themelore për mbrojtje të fëmijëve nga përmbajtje jo-përkatëse (përmbajtje pornografike), në esencë e pasqyron edhe të kuptuarin e shkrim-leximit mediatik. Me ri-emërtimin e saj në Direktivë për shërbime audiovizuale mediatike në vitin 2007. Njohuritë mediatike fiton rëndësi dhe rol të veçantë. Përkatësisht, ajo është e definuar qartë si *“...shkathtësi, dituri dhe të kuptuar që konsumuesve ju mundëson që mediet ti përdorin në mënyrë efikase dhe të sigurt. Individët që kanë njohuri mediatike janë në gjendje të bëjnë zgjedhje të informacioneve, ta kuptojnë natyrën e përmbajtjeve dhe të shërbimeve për ti shfrytëzuar avantazhet e tërë spektrit të mundësive që i ofrojnë teknologjitë e reja komunikuese. Ata janë më mirë të aftësuar të mbrojnë veten dhe familjet e tyre nga material të dëmshëm ose abuziv. Prandaj, duhet të promovohet zhvillimi i njohurive mediatike në të gjitha pjesët e shoqërisë dhe të monitorohet me kujdes zhvillimi i saj.”*⁵ Me këtë rast, Direktiva thirret edhe në Rekomandimin e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës nga viti 2006 për mbrojtje të të miturve dhe të dinjitetit njerëzor bë shërbimet audiovizuale dhe informatike e cila përmban një varg të masave për promovim të njohurive mediatike, si p.sh., edukim i vazhdueshëm i mësime të mësimdhënësve dhe edukatorëve,

3 Shih: Paris Agenda or 12 Recommendations for Media Education, https://www.diplomatie.gouv.fr/IMG/pdf/Parisagendafr_en.pdf

4 Për shembull, në vitin 2016 tema e javës Botërore të njohurive mediatike dhe informatike ishte “Njohuritë mediatike dhe informatike: paradigma të reja për dialog ndër kulturor”, ndërsa në vitin 2017 “Njohuria mediatike dhe informatike në kohërat kritike: nxitja e mënyrave të reja të të mësuarit dhe të ambientit informatik”.

5 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2007/65/oj>

6 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/eli/reco/2006/952/oj>

në bashkëpunim me shoqatat për mbrojtje të fëmijëve, për përdorimin e internetit në procesin edukativ, aplikimin e trajnimit specifik për internet të orientuar ndaj fëmijëve që nga moshën e tyre e hershme, përfshirë edhe sesione të hapura për prindërit, si dhe qasje të integruar arsimore si pjesë e programeve arsimore në shkollat dhe programet për njohuri mediatike që kanë për qëllim përdorim të përgjegjshëm të internetit.

Në këtë kontekst, veçmas theksohet **Rekomandimi për edukimin mediatik** të Asamblesë Parlamentare⁷ nga viti 2000, dokumenti i cili në mënyrë të detajuar dhe eksplicite merret me çështjen e shkrim-leximit mediatik. Në të veçanërisht apostrofohet ndikimi i medieve mbi fëmijët që ndonjëherë nuk janë në gjendje ta dallojnë realitetin e medias nga realiteti i vërtetë dhe theksohet nevoja për zhvillim të edukimit mediatik me qëllim të përdorimit aktiv, kritik dhe të arsyeshëm të medieve. Në dokumentin përkufizohet edukimi mediatik si një mjet për realizimin e të drejtës për shprehje të lirë dhe të informimit, e dobishme jo vetëm për zhvillimin personal të individit, por edhe për pjesëmarrje dhe ndërveprim më të madh në shoqërinë. Me këtë rast, pa marrë parasysh që edukimi mediatik është pjesë e kurikulave në disa vende evropiane, zbatimi i tij praktik ende është problematik, posaçërisht në raport me metodologjinë e edukimit, qëllimet që duhet ti përcjell dhe evaluimin e rezultateve. Prandaj, edhe rekomandimet për qeveritë dhe autoritetet përkatëse të vendeve-anëtare që të nxisin përpilim dhe zhvillim të programeve për shkrim-leximin elementar mediatik për fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit, që të promovojnë programe të trajnimit për mësuesit në fushën e edukimit mediatik, që të përfshijnë institucionet arsimore, organizatat e prindërve, profesionistët e medias, ofruesit e shërbimeve të internetit, organizatat joqeveritare dhe aktorët e tjerë në një dialog aktiv për këto çështje, si dhe të eksplorojnë mënyrat për të mbështetur programet arsimore në media të ndryshme për promovimin e edukimit mediatik në ato.

Prej atëherë e më tutje, shkrim-leximi mediatik është i pranishëm në pothuajse të gjitha dokumentet e ndërlidhura me mediet, por fokusi ngadalë lëviz drejtë mediet dhe shërbimet komunikuese të reja. Kështu, në konferencën “Integrimi dhe diversitetet: kufij të ri të politikës evropiane mediatike dhe të komunikimit” (Integration and diversity: the new frontiers of European media and communications policy), të mbajtur në Kiev në vitin 2005, në Rezolutën numër 3 “Të drejtat e njeriut dhe rregullimi i medieve dhe të shërbimeve të reja të komunikimit në shoqërinë informatike”, shtetet anëtare obligohen që ti shtojnë “përpjekjet për sigurim të qasjes efikase dhe të drejtë për të gjithë individët në shërbimet, dituritë dhe shkathtësitë e reja komunikuese, për ta penguar përjashtimin digjital, dhe për ti nxitur edukimin mediatik të opinionit më të gjerë”, e posaçërisht “trajnim për fëmijët në fushën e edukimit mediatik për të pasur dobi nga aspektet pozitive të shërbimeve të reja komunikuese dhe që ta shmangin ekspozimin ndaj përmbajtjeve të dëmshme”. Shkrim-leximi mediatik është pjesë e planit Aksionar të miratuar në Konferencën, me të cilin shtetet obligohen që ti “përkrahin hapat për promovim të edukimit mediatik në të gjitha shkallët e arsimit dhe si pjesë e procesit të mësimt”.⁸

7 Shih: <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=16811&lang=en>

8 Shih: <https://rm.coe.int/16806461fb>, faq. 46

Në vitin 2007, Komisioni Evropian do të miratojë Kumtesë – *Qasje Evropiane ndaj edukimit mediatik në ambientin digjital*⁹ (A European approach to media literacy in the digital environment) në të cilën, krahas definicionit, janë theksuar edhe nivelet e ndryshme të edukimit mediatik. Ajo përfshin: ndjesi të komoditetit me të gjitha mediet ekzistuese që nga gazetatat deri te bashkësitë virtuale; përdorim aktual i medieeve përmes televizionit inter-aktiv, përdorim i internet kërkuesit ose pjesëmarrje në bashkësitë virtuale dhe përdorim më i mirë i potencialeve të medieeve për zbatimje, qasje në kulturën, dialogu ndër-kulturor, mësimi dhe aplikacionet e përditshme (për shembull, përmes bibliotekave, nënkasteve); qasje kritike ndaj mediet në lidhje me cilësinë dhe saktësinë e përmbajtjes (për shembull, mundësia për tu vlerësuar informacioni, ballafaqimi me shpalljet në medie të ndryshme, përdorim racional i kërkuesve); përdorimi kreativ i medieeve, si rezultat i evolucionit të teknologjive mediatike dhe rritje e pranisë në internet si kanal shpërndarës i cili mundëson rritje të vazhdueshme të numrit të atyre që krijojnë dhe shpërndajnë fotografi, informacione dhe përmbajtje; kuptimi i ekonomisë së medieeve dhe dallimi midis pluralizmit dhe pronësisë së medieeve; vetëdije për çështjet e të drejtave autoriale që janë me rëndësi kyç për “kulturën e ligjshmërisë” posaçërisht për gjeneratën më të re e cila vepron në cilësi të dyfishtë, si konsumues dhe si prodhues i përmbajtjeve. Padyshim, koncepti që Komisioni Evropian e zhvillon për shkrim-leximin mediatik përfshin njohuri të shumta “individuale” të cilat sot përdoren me bollëk, si njohuri informatike, edukim digjital, njohuri audiovizuale, njohuri filmike, njohuri kulturologjike....

Kështu, *Rekomandimi i Komisionit Evropian për njohuri mediatike në ambientin digjital*¹⁰ e vitit 2009, vë në pah qartë se shpërndarja e përmbajtjeve kreative digjitale dhe multiplikimi i onllajn platformave dhe atyre mobile për distribuim, gjenerojnë sfida të reja për edukimin mediatik. Në botën e sotme, qytetarët duhet të zhvillojnë shkathtësi analitike të cilat mundësojnë kuptimin më të mirë intelektual dhe emocional të medieeve digjitale. Nga kjo buron “kërkesa” që edukimi mediatik të jetë i përfshirë në mënyra të ndryshme dhe në nivele të ndryshme në shoqërinë. Ai është shkathtësi themelore jo vetëm për të rinjtë, por edhe për të rriturit dhe më të moshuarit, për prindërit, arsimtarët dhe profesionistët e medieeve. Përkatesisht, përgjegjësi parësore e vendeve anëtare është zhvillimi i modaliteteve për përfshirje të edukimit mediatik në programet arsimore në të gjitha nivelet. Shoqëri me edukim mediatik është ajo shoqëri e cila në të njëjtën kohë është edhe nxitje dhe parakusht për pluralizëm dhe pavarësi në mediet. Në atë drejtim, Komisioni propozon hulumtim sistematik të aspekteve të ndryshme dhe të dimensioneve të shkrim-leximit mediatik në rrethimin digjital, si dhe hapje të debateve dhe të eventeve të ndryshme publike për përfshirje të edukimit mediatik në programin e obligueshëm arsimor.

Ndërkohë do të vijojnë hulumtime dhe studime të shumta për implementim, për vlerësim (me kritere dhe indikatorë) në nivelin e njohurive mediatike në vendet anëtare të Unionit Evropian dhe më gjerë. Me këtë rast, transferimi i kompetencës për njohuri mediatike nga Drejtoria e Përgjithshme për shoqëri informatike dhe

9 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM%3A2007%3A0833%3AFIN%3AEN%3APDF>

10 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32009H0625>

medie në drejtorinë e përgjithshme për arsim dhe kulturë në vitin 2010, në esencë është përpjekje që edukimi mediatic në mënyrë edhe më bazike të lidhet me arsimin. Prej vitit 2012 vëmendja posaçërisht është e orientuar në implementimin e edukimit mediatic si pjesë e obligueshme të planeve arsimore dhe programet në arsimin. Në atë drejtim janë edhe *Konkluzionet për zhvillimin e shkrimç-leximit mediatic dhe i të menduarit kritik përmes edukimit dhe trajnimit*¹¹ (Conclusions on developing media literacy and critical thinking through education and training) të Këshillit për arsim, të rinj, kulturë dhe sport i Unionit Evropian nga viti 2016. Këshilli i fton vendet në:

(1) *nxitje të vëmendjes së mjaftueshme të përkushtuar zhvillimit të shkrim-leximit mediatic dhe të menduarit kritik në arsimin si dhe aftësimi në të gjitha nivelet, duke e përfshirë edhe arsimin qytetar dhe mediatic,*

(2) *përpjekje për tu ngritur niveli i kompetencave digjitale midis nxënësve të të gjitha grup-moshave në arsimin, si parakusht i rëndësishëm për forcimin e aftësisë së tyre për pjesëmarrje aktive në jetën demokratike të shoqërive bashkëkohore, si dhe rritje e mundësisë së tyre për punësim,*

(3) *nxitje e ambientit të sigurt për mësim, si onllajn ashtu edhe ofllajn, në të cilin për çështjet kontroverse mund të debatohet hapur, të ballafaqohet liria e shprehjes, si dhe nxitet kuadri arsimor të nxis dhe modele diskutime të tilla,*

(4) *përkrahje e kuadrit arsimor dhe të udhëheqësve shkollor në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnim si dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional të kompetencave të tyre digjitale, si dhe shkathtësi pedagogjike të nevojshme për përdorim të teknologjive të reja të resurseve arsimore gjatë mësimin me mënyrë efektive të zgjidhjes së çështjes së shkrim-leximit mediatic dhe mendimi kritik me nxënës nga të gjitha moshave dhe prejardhjeve,*

(5) *përfshirje e prindërve dhe palëve të tjera të prekura në shoqërinë për tu zvogëluar hendeku digjital midis gjeneratave dhe të nxitet kulturë e përbashkët e dialogut dhe të të kuptuarit të ndërsjellë,*

(6) *fuqizimi i dialogut, bashkëpunimit dhe partneritetit midis sektorit arsimor dhe atij të trajnimit bashkë me sektorin mediatic - duke i përfshirë edhe gazetarët – si dhe palët e tjera të prekura relevante, përfshirë këtu edhe shoqëria civile dhe organizatat rinore, duke pasur parasysh atë se zhvillimi efikas i njohurive mediaticke dhe mendimi kritik kërkojnë qasje multidisiplinare me theks në rolin e rëndësishëm që në atë kuptim e ka mësimi jo-formal,*

(7) *nxitje e mënyrave inovative, kreative dhe pjesëmarrëse për zhvillim të shkrim-leximit mediatic dhe të të menduarit kritik në arsimin dhe aftësimin, për shembull, me zbatimin e hulumtimeve dhe studimeve të potencialeve të cilat kulturën dhe artin, qas-*

11 Shih: <http://www.eunec.eu/sites/www.eunec.eu/files/attachment/files/conclusions.pdf>

jen intern-kulturore dhe produksionit e medieve shkollore mund ta ofrojnë si mjet për përforcimin e transparencës ndaj kulturave të tjera dhe qytetari aktive.

Skrim-leximi mediatik edhe sot mbetet pjesë kyç e politikave të Unionit Evropian për politikën audiovizuale, mediet dhe programit për internet më të sigurt deri te politika arsimore dhe mësimin e përjetshëm. Ajo është element i disa iniciativave prijëse edhe nga Strategjia e UE 2020, siç janë agenda digjitale ose shkathtësitë e reja për vendet e reja të punës.¹² Padyshim, edhe në të ardhmen detyrë e Unionit Evropian do të jetë fuqizimi i mëtejme i shkrim-leximit mediatik, kërkesa për edukim mediatik, inkurajim i të interesuarve në sektorin publik dhe privat për iniciativë më të madhe në procesin e përshtatjes në rezultatet e reja nga hulumtimi i njohurive mediatike ose zhvillimi i teknologjive të reja. (Ding, 2011:7)

12 Shih: EUROPE 2020 , A European strategy for smart, sustainable and inclusive growth, <http://ec.europa.eu/eu2020/pdf/COMPLET%20EN%20BARROSO%20%20%20007%20-%20Europe%202020%20-%20EN%20version.pdf>

3.

Praktikimi i edukimit mediatik – shembulli i Sllovenisë bibliografi

The knowledge society in which Europe functions requires that media literacy has a place at the core of education.
(EAVI, 2009:85)

Edukimi për shkrim-lexim mediatik në Evropë paraqitet në kontekste të ndryshme, varësisht nga traditat e ndryshme të sistemeve shkollore, ndërsa në praktikën hasen në kontekste të ndryshme. Më shpesh bëhet fjalë për shkrim-lexim mediatik ose si lëndë e veçantë, ose integrimi i tij, përmes njësive të ndryshme metodike, në më shumë lëndë mësimore. Pikërisht qasja e tillë edhe sot e tërheq vëmendjen e ekspertëve, posaçërisht për shkak të njohurive se edukimi mediatik (më shpesh zgjedhor) si lëndë e veçantë është ulët në listën e prioriteteve për shkollat dhe arsimtarët, ndërsa integrimi i tij në lëndët e tjera shkollore e bën “të padukshme”; kështu që është më vështirë të mësohet, përkatësisht çdo arsimtar mëson “nga pak”. Konsensus nuk ka, pa marrë parasysh që dominon e a.q. qasje “interkulikulare”.

Finlanda është vend i cili më shpesh përmendet si “rrëfim i suksesshëm” në lidhje me shkrim-leximin mediatik. Termi *edukimi mediatik* (Mediakasvatus) është i definuar si arsim me mediet dhe arsim për to. Qëllimi është përvetësimi i shkathtësive të dobishme gjatë krijimit të medieve, të kuptuarit e produksionit mediatik dhe të informimit mediatik, i menduari për raportin ndaj medieve dhe zbatimi i të menduarit kritik dhe vetë-shprehjes. Në aplikim e sipër është qasja interkulikulare, në arsimin fillor me fushë tematike “shkathtësi mediatike dhe komunikim”, ndërsa në nivel sekondar, “komunikim dhe kompetenca mediatike”. Zakonisht edukimi mediatik mësohet në kuadër të gjuhës amtare, ndërsa theksi është mbi të mësuarit se si të kuptohet teksti dhe gjuha nga perspektiva e ndikimit të medieve, gjë e cila kërkon praktikë, analizë dhe dituri. Kurikula në mënyrë eksplicite thekson se nxënësit patjetër duhet ta përmirësojnë shkrim-leximin e vet për të mund në mënyrë të drejtë të shpjegojnë mesazhe të ndryshme që i marrin nga mediet, ta vlerësojnë kontekstin dhe funksionin e atyre mesazheve dhe të kuptojnë se si ato mesazhe mund të ndikojnë mbi individët në shoqërinë në tërësi.¹ Këtu mund të përfshihen gjithashtu *Norvegjia* dhe *Mbretëria e Bashkuar*, ku edukimi në media është gjithashtu, është pjesë përbërëse e gjuhës amtare dhe luan rol kyç për të tashmen dhe të ardhmen e shoqërisë. *Danimarka* i përfshin “mediet dhe TKI-edukimin” në arsimin fillor dhe të mesëm në tri mënyra: integrimin e tyre me mjetet didaktike në të gjitha lëndët arsimore në gjuhën amtare dhe si pjesë e lëndëve zgjedhore të ndërlidhura me mediet (përpunim teksti, arte vizuale, fotografi, studime filmike, përpunimit elektronik i të dhënave).²

Në *Irlandë*, edukimi për mediet është definuar si edukim mediatik kritik (Critical Media Literacy Education) me qëllimin parësor të arsimit të gjerë, para së gjithash, për shkak të ndërthurjes mediatike me jetën profesionale, qytetare dhe personale të

1 Shih më tepër në: https://www.mediawijzer.net/wp-content/uploads/sites/6/2013/10/rapport_media_onderwijs_EU.pdf si dhe <http://julkaisut.valtioneuvosto.fi/bitstream/handle/10024/75280/OKM13.pdf>

2 Shih më tepër në: http://ppemi.ens-cachan.fr/data/media/colloque140528/rapports/DENMARK_2014.pdf

njerëzve. Fokusi është në dy drejtime – “zhvillimi i qytetarisë” dhe “edukimi mediatic”, përkatësisht veht theks i dyfishtë në mbrojtjen dhe fuqizimin. Mësimdhënësit duhet t’i inkurajojnë fëmijët që të shqyrtojnë në mënyrë kritike mediet dhe të eksplorojnë se si mund të ndikojnë mbi sjelljen dhe të menduarit, por gjithashtu të kenë mundësi ta eksplorojnë gamën e informacioneve që i kanë në dispozicion të tyre nëpërmjet teknologjive informatike-të komunikimit.³ Çekia edukimin mediatic e përfshin në programin e arsimit fillor që nga viti 2000, dhe që nga viti 2007 ligjërohet si një lëndë ndërkulturore. Qëllimi i tij (i përcaktuar në programin e arsimit fillor) është që t’u ofrojë nxënësve një nivel themelor të shkrim-leximit mediatic, që përfshin njohje të informacioneve bazë për funksionin dhe rolin e medias në shoqërinë bashkëkohore (historinë, strukturën) dhe përvetësimin e shkathtësive që e lehtësojnë ndërveprimin e pavarur të individit me mesazhin mediatic. Ajo përfshin aftësi për tu analizuar mesazhet, të vlerësohet besueshmëria dhe qëllimi i tyre, si dhe aftësia për të zgjedhur medium të përshtatshëm për përmbushje të nevojave të ndryshme - si burim i informacioneve, edukimit, aktivitete në kohën e lirë.⁴

Përballë asaj, në *Holandë*, edukimi mediatic për dekada me radhë është në rend dite, por nuk është e përfshirë në kurikulat dhe programet si një lëndë e veçantë. Në fakt, edukimi mediatic është i “lënë” përkushtimit dhe entuziazmit të stafit mësimdhënës dhe udhëheqjes së shkollës, ndërsa shihet edhe në aktivitetet jashtëshkollore. Ekziston në arsimin e mesëm, por si një “edukim audiovizuale” që e përfshin arsimin artistik dhe e thekson aspektin estetik të përmbajtjeve mediatiche, ndërsa burimet burojnë nga artet audiovizuale, si fotografitë, filmi, videoja.⁵ Në *Bullgari*, në vend të shkrim-leximit mediatic, avantazh kanë shkrim-leximi informatik, kompjuterik dhe digjital. Shkrim-leximi mediatic kryesisht ligjërohet në universitete, ndërsa në shkollat kjo i është lënë veprimtarisë së ligjëruesve të jashtëm. Megjithëse shkollat janë të pajisura teknologjikisht në një nivel të kënaqshëm, nuk ka kurrikulë të veçantë për shkrim-leximin mediatic.⁶ Edhe në *Spanjë*, plan-programet shkollore nuk përmbajnë kurse specifike të përqendruara mbi shkrim-leximin mediatic, edhe pse ka shembuj të izoluar të arsimtarëve që përfshijnë përmbajtje mediatiche në mësimdhënie. Prandaj, ndërkaq shkathtësitë informatike-digjitale janë të integruara në të gjitha nivelet e arsimit.⁷

MODELI SLOVEN I EDUKIMIT MEDIATIK

Slovenia është vendi i parë në Evropën Qendrore dhe Lindore e cila e aplikon shkrim-lexim mediatic në sistemin arsimor. Proceset e filluara në vitet ‘90-ta në arsimin “hyjnë” në vitin 1996, që përkon me periudhën (1990-1998) të transformimit të sistemit arsimor në shtetin. Edukimi mediatic, i definuar si “proces i mësimin për mediet dhe me mediet” zyrtarisht që nga viti 1999 u bë pjesë e programeve arsimore të arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë (me ëndë të veçantë për arsimtarët), ndërsa që nga viti 2000

3 Shih më tepër në: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ889203.pdf>

4 Shih më tepër në: https://www.shs-conferences.org/articles/shsconf/pdf/2016/04/shsconf_erp2016_01092.pdf

5 Shih më tepër në: https://www.mediawijzer.net/wp-content/uploads/sites/6/2013/10/rapport_media_onderwijs_EU.pdf

6 Shih më tepër në: <http://oaji.net/articles/2016/2466-1462764572.pdf>

7 Shih më tepër në: http://ppemi.ens-cachan.fr/data/media/colloque140528/rapports/SPAIN_2014.pdf

- pjesa fakultative e edukimit parashkollor për fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjeç. Në shkollat fillore ky proces fillon me aplikimin e arsimit nëntëvjeçar, ndërsa shkrim-leximi mediatik përfshihet në mësimdhënien e detyrueshme (ndërkulikulare), si dhe në mësimin zgjedhor (me një lëndë të veçantë), ndërsa në arsimin e mesëm - interkurrikulare me tema mësimore në disa lëndë (gjuha Sllovene, Sociologjia, Psikologjia, Historia e Artit). Në fakt, bëhet fjalë për **një model të kombinuar** të edukimit me përfshirjen e shkrim-leximit mediatik në lëndët e detyrueshme (mbi të gjitha, në kuadër të gjuhës amtare), në mësimin zgjedhor dhe në aktivitete të ndryshme jashtëshkollore. Përveç se në arsimin formal, shkrim-leximi mediatik është pjesë edhe e iniciativave jofor-male, më shpesh në organizatat rinore, në mënyrë që të zhvillohet aftësia e të rinjve për ti përdorur në mënyrë kritike mediet, por gjithashtu për ta inkurajuar krijimtarinë e tyre në prodhimin mediatik. Që atëherë deri më sot nuk ka pasur ndryshime më të rëndësishme, e as mbindërtim ose, ndërkaq, modernizim të modelit të përcaktuar të edukimit të shkrim-leximit mediatik.

1. Shkrim-leximi mediatik si pjesë nga mësimi i obliguar. Në shkollat fillore, arsimi mediatik përfaqësohet nga përmbajtje të ndryshme tematike në dy lëndë të detyrueshme - gjuha Sllovene nga klasa 1 deri në klasën e 9 dhe Edukimi civil dhe etika për klasën e 8. Në mënyrë të tërthortë, përmbajtja e caktuar mediatike janë përfshirë edhe në programet arsimore të lëndëve Historia, Gjeografia, edukimi Artistik dhe edukimi Muzikor.

Në mësimdhënien e *gjuhës Sllovene*, nxënësit me shkrim-lexim mediatik mund hasen që në periudhën e parë edukativo-arsimore (nga klasa 1. deri në klasën 3.). Sipas planit më të ri mësimor (të azhurnuar) që do të zbatohet nga viti shkollor 2019/20, qëllimi i lëndës, krahas leximit dhe shkrimit, është edhe biseda, pranimi kritik dhe interpretimi i teksteve të ndryshme, zhvillimi i aftësive linguistike, interpretimi, vlerësimi, vlerësimi dhe zhvillimi aktiv i aftësive komunikuese, kognitive dhe imagjinative, përvoja dhe interesa përmes krijimeve të teksteve të ndryshme, komunikim të dyanshëm, krijimi i kumtesave të shtypura dhe elektronike, pranimi, i kuptuari, perceptimi dhe vlerësimi i teksteve promovuese etj. Në këtë mënyrë, zhvillohen në mënyrë sistematike të gjitha komponentët e aftësive të komunikimit, njëkohësisht duke i rritur njohuritë për krijimin, pranimin, kuptimin, përjetimin dhe vlerësimin e suksesshëm të teksteve në format e reja të medieve që i sjell epoka elektronike.

Në mënyrë operative, në periudhën e parë të arsimor-edukativ, në kuadër të fushës së letërsisë, një pjesë e veçantë i kushtohet “teatrit, radio-lojës, filmit vizatimor dhe filmit”. Këtu nxënësit njihen me:

- Shfaqja teatrore/e kukullave – i dallojnë personazhet kryesore dhe të tjera, e përjetojnë hapësirën dhe elementet e tjera të ngjarjes teatrore, e zhvillojnë vetëdijen për ngjashmërinë/llojllojshmërinë e eventit teatror dhe fabulën e njohur; e përtërijnë ngjarjen dhe e ndërlikojnë me përvojat e veta; bisedojnë çka i ka tërhequr/dëbuar në realizimin; marrin pjesë në luajtjen e roleve,
- Radio-loja – i shprehin përvojat, kuptimet dhe vlerësimet e tyre në radio-lojën; krijojnë një fotografi të imagjinuar të njerëzve bazuar në specifikat e gjuhës së tyre dhe në audio - pajisjet radio të radio-tekstit; flasin për elementet e audio-pajisjes të radio lojës;

- Filmi vizatimor – e shprehin përvojën e vet, kuptimin dhe vlerësimin e filmit vizatimor; e krahasojnë kuptimin e tyre të stories në filmin vizatimor me të kuptuarin e shokëve të klasës; i identifikojnë dallimet midis filmit vizatimor të incizuar sipas propozimit letrar dhe tekstit burimor; të njihen me karakteristikat themelore të medieeve,
- Filmi – e shprehin përjetimin, kuptimin dhe vlerësimin e filmit për fëmijë; në filmin e xhiruar sipas propozimit letrar ata flasin për ngjashmëritë/dallimet midis tekstit dhe filmit; i kuptojnë dallimet midis filmit vizatimor dhe filmit; vetëdijesohen për karakteristikat e medieeve.

Në periudhën e dytë arsimore-edukative (nga klasa e 4-të deri në të 6-tën), vëmendje i kushtohet “teatrit, radios dhe filmit”. Te nxënësit zhvillohet vetëdija për karakteristikat e përpunimit mediatic, realizimin dhe aktualizimin e teksteve letrare, njohjen e karakteristikave themelore të medieeve individuale, krahasimin e performancave teatrore, të radios dhe arte filmike me tekstet letrare, shprehje e përvojës së vet, kuptimi dhe vlerësimi i performancës/radio-lojës/filmit. Konkretisht, në:

- Shfaqjen teatrore/të kukullave – e kuptojnë ngjarjen dramatike, i dallojnë personazhet kryesore nga personazhet anësore dhe veçoritë dhe disponimet e tyre, i dallojnë tiparet e teatrit, të ngjarjes, regjisorit, aktorëve, roleve të caktuara, skenës, dritës, kostumeve, muzikës, llojeve të kukullave; i paraqesin konkluzionet e tyre, i krahasojnë dhe i shpjegojnë ato;
- Radio-loja – nëpërmjet informacioneve tingëlluese formojnë një fotografi për personalitetet (dukja e jashtme, karakteristikat personale, motivet për sjelljen e tyre), për hapësirën dhe kohën, e vlerësojnë radio-lojën - identitetin vizual të personave dhe hapësirën, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e audio-pajisjeve;
- Filmi – e përjetojnë, e kuptojnë dhe e vlerësojnë filmin trivial/zbavitës dhe artistik;
- Krahasimi i teatrit/filmit me tekstin letrar (shembuj të zgjedhur të teksteve dhe emisioneve) – e krahasojnë fantazinë e tyre (të personalitetit, hapësirës dhe kohës) me njerëzit, skenën dhe kostumet, i vëzhgojnë dhe i theksojnë dallimet midis një dhe mediumit tjetër.

Periudha e tretë arsimore-edukative (nga klasa e 7 deri në klasën e 9-të) në mënyrë operative vazhdon të funksionojë me “teatrin, radio-lojën dhe filmin”, ndërsa nxënësit në mënyrë gojore ose me shkrim e shprehin përjetimin e vet, kuptimin dhe vlerësimin e shfaqjes teatrore, të radio-lojës dhe të filmit, i njohin karakteristikat e përpunimit, realizimit, aktualizimit të teksteve artistike, përkatësisht karakteristikat themelore të medieeve të caktuara, dhe e krahasojnë performancën teatrore, radio-lojën dhe filmin me tekstin letrar.

Në fund të programit, në rekomandimet didaktike, një seksion i veçantë i kushtohet teknologjive informatike. Përkatësisht, rekomandohet që mësuesit ta planifikojnë përdorimin e teknologjive informatike për ta inkurajuar aktivitetin, motivimin e tyre dhe shkrim-leximin digjital të tyre. Një metodë e përshtatshme konsiderohet i mësuarit i përbashkët përmes aktiviteteve të onllajn mjediseve të ndryshme, siç janë forumet, përdorimi i anketave ose forma të tjera të verifikimit, video-konferenca për lidhjen me nxënësit e shkollave të tjera, përdorimi i rrjeteve sociale etj. Puna me teknologjitë in-

formatike përfshin edhe punë me e-përmbajtje me cilësi të lartë (e-materiale, e-libra, e-tekstet shkollore, onlajn fjali) dhe e-shërbime. Gjithashtu mësimdhënësit duhet ti informojnë nxënësit për përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë informatike dhe si mund të kontribuojnë në ueb-faqen.⁸

Lënda *Edukimi qytetar dhe etika* mësohet në klasën e 7-të dhe të 8-të. Qëllimi i tij i përgjithshëm është zhvillimi i shkrim-leximit politik, mendimit kritik për qëndrimet dhe vlerat e caktuara, si dhe përfshirja aktive në jetën shoqërore. Temat e ndërlidhura me mediet mësohen në klasën e 8-të (plani programor) është nga viti 2011), në tërësi të posaçme programore “Demokracia nga afër”⁹ (nga gjithsej katër njësi mësimore), ku përveç për pushtetit demokratik, referendumit, zgjedhjeve, partive politike, nxënësit mësojnë për rëndësinë, rolin dhe ndikimin e medieve në shoqërinë, me synime të përcaktuara qartë për të cilat vetë mësimdhënësit vendosin nëse do ti realizojnë ashti siç rekomandohet në programin. Konkretisht, bëhet fjalë për përmbajtjet vijuese: qytetarë të mire-informuar dhe kritik dhe media kritike: pushteti duhet të veprojë publikisht (njohja përse është e rëndësishme që pushteti të veprojë publikisht), mediet ta kontrollojnë pushtetin, pluralizmin e medieve (ndërlidhja e nocioneve demokraci, opinion dhe përgjegjësi) dhe rregullat dhe normat e debatit publik, kufijtë e medieve (përmes shembujve të njohjes së rolit të medieve gjatë zbulimit të keqpërdorimeve të pushtetit, me mediet kryesore në Slloveni dhe zhvillimin të shkrim-leximit kritik ndaj tyre).

2. Shkrim-leximi mediatic si pjesë e mësimiit zgjedhor. Brenda programit arsimor për arsimi fillor, krahas lëndëve obliguese, ka edhe një numër të madh (më shumë se 80) të atyre zgjedhore¹⁰, nga të cilat shkollat (drejtori dhe arsimtarët) zgjedhin pesë dhe u “ofrojnë” nxënësve. Në këtë grup, krahas gjuhëve të ndryshme (gjermane, franceze, kineze, maqedonase, kroate, ruse dhe të tjera), propozohen edhe Astronomia, Etnologjia, Gjenetika, Logjika deri te Bletaria, Tastierë dhe Kompjuterë, Valle, Shah dhe të tjera. Në lidhje me edukimin mediatic janë disa lëndë, si për shembull *Shkrim-leximi kompjuterik* (për klasën e 9-të), përmes të cilës zhvillohen strategji kognitive për përvetësim, analizë, përzgjedhje, sintetizim, vlerësim dhe përdorim kreativ dhe parqitje të informacioneve në të gjitha nivelet dhe fushat. Lënda e përfshin kuptimin dhe përdorimin kreativ të informacioneve përmes teknologjisë moderne, burimeve moderne të kompjuterike dhe të komunikimit.¹¹ Pastaj, *Dizajni artistik* I, II dhe III (për klasën e 7, 8 dhe 9), nëpërmjet të cilit nxënësit zhvillojnë aftësi për të vëzhguar/imagjinuar të shprehjes artistike, interes për forma të ndryshme të arteve figurative, për aftësinë për ta vlerësuar në mënyrë kritike punën e tyre, për punën e kolegëve dhe të artistëve, dhe aftësia për ti kuptuar dhe vlerësuar mediet e ndryshme të kulturës vizuale.¹² Ose

8 Shih më tepër në Programin për Gjuhën sllovene: http://www.mizs.gov.si/fileadmin/mizs.gov.si/pageuploads/podrocje/os/prenovljeni_UN/UN_slovenscina.pdf

9 Shih më tepër në: http://www.mizs.gov.si/fileadmin/mizs.gov.si/pageuploads/podrocje/os/prenovljeni_UN/UN_DDE_OS.pdf

10 Shih: http://www.mizs.gov.si/si/delovna_podrocja/direktorat_za_predsolsko_vzgojo_in_osnovno_solstvo/osnovno_solstvo/program/abecedni_seznam_izbirnih_predmetov_v_osnovni_soli/#c17860

11 Shih më tepër në: http://www.mizs.gov.si/fileadmin/mizs.gov.si/pageuploads/podrocje/os/devetletka/predmeti_izbirni/Informacijsko_opismenjevanje_izbirni.pdf

12 Shih më tepër në: http://www.mizs.gov.si/fileadmin/mizs.gov.si/pageuploads/podrocje/os/devetletka/predmeti_izbirni/Likovno_snovanje_izbirni.pdf

lënda *Kompjuterë* (për klasën e 7, 8 ose 9), ku nxënësit jo vetëm që i njohin nocionet themelore dhe rëndësinë e teknologjisë kompjuterike në shoqërinë moderne dhe fitojnë zakone dhe shkathtësi për përdorimin efikas të saj për kënaqje të nevojave të tyre, por edhe formojnë qëndrime mbi informacionet e përvetësuar, si dhe qëndrim të duhur ndaj mbrojtjes së pronësisë (të drejtat e autorit) dhe mbrojtjen e të dhënave personale.¹³

Lëndë e veçantë (e obligueshme për shkrim-lexim mediatik është **Edukimi për mediet** (plani arsimor i vitit 2006)¹⁴, me tre tërësi të rrumbullakosura tematike – shtyp, radio dhe televizion, të cilat plotësohen mes vete, por nxënësit mund të zgjedhin edhe vetëm një tërësi. Mësimi i kësaj lënde është paraparë për ciklin e fundit trevjeçar të arsimit, për klasën e 7, 8 dhe 9 me gjithsej 35 orë në vit, përkatësisht një orë në javë. Qëllimi është që nxënësit të mësojnë të analizojnë në mënyrë kritike, të vlerësojnë dhe të krijojnë forma të ndryshme mediatike, të jenë me shkrim-lexim informatik dhe funksional, ti analizojnë avazet e tyre në perceptimin e medieve, ta korrigjojnë varësinë e mundshme të medias dhe të jetë e mundur dhe të mësojnë që në mënyrë kreative dhe kritike të zgjedhin medie, të jenë qytetarë aktivë e jo konsumatorë pasiv, të përfitojnë aftësi të komunikimit, aftësi për të dalluar realitetin nga fikcioni, aftësi për të shprehur pikëpamjet dhe për debat, për të fituar njohuri në lidhje me funksionimin e Institucioneve të medias, kategorive të medieve, teknologjia e gjuhës mediatike, publiku, të mësojnë se mediet e konstruktojnë realitetin, të veprojnë sipas rregullave të tyre, të ndërmjetësojnë informacione ideologjike dhe vlera të informacionit, që veprojnë kryesisht në parimet e tregut, ndërsa në praktikë – se si një formësohen lajmet zhanret gazetareske në media të caktuara, që vjen deri te konstruktimi i domethënies, siç është rutina afariste e gazetarëve.

Në tërësinë e parë tematike – Shtypi – nxënësit njihen me shfaqjen dhe zhvillimin e shtypit masiv, karakteristikat e medieve të shkruar (publiciteti, aktualiteti, universaliteti), ndarja e shtypit (i përditshëm, javor), puna gazetareske në shtypin. Në fund të mësimit, nxënësit e publikojnë revistën e tyre. **Në tërësinë e dytë tematike - Radio** – për nga ana përmbajtësore nxënësit njihen me paraqitjen e radios, karakteristikat e tij, ndarjen e radiostacioneve (nacionale, lokale, komerciale), puna gazetareske në radio-stacion, publiku mediatik. Këtu nxënësit krijojnë radio-emisione vetanake. **Në tërësinë e tretë tematike - Televizioni** – theksi është mbi paraqitjen e TV, karakteristikat e saja, ndarja e TV stacioneve (kabllore, satelitore), puna gazetareske në televizion, interneti, efektet nga mediet masive, mediet dhe idhujt, mediet dhe dhuna, mediet dhe stereotipat. Programi rrumbullakoset me shkrimin e letrave TV-redaktorëve për ndryshim të përmbajtjeve mediatike. Në të tria tërësitë tematike ka disa përmbajtje metodike: karakteristika të medieve, etika gazetareske, shpallja dhe propaganda, konstruktim i realitetit mediatik si dhe si të bëhesh individ kritik mediatik.

3. Sfida dhe perspektiva në të mësuarin e shkrim-leximit mediatik. Modeli i

13 Shih më tepër në: http://www.mizs.gov.si/fileadmin/mizs.gov.si/pageuploads/podrocje/os/devetletka/predmeti_izbirni/Racunalnistvo_izbirni.pdf

14 Shih: http://www.mizs.gov.si/fileadmin/mizs.gov.si/pageuploads/podrocje/os/devetletka/predmeti_izbirni/Vzgoja_za_medije_izbirni.pdf

vendosur i edukimit mediatik, pa çfarë do qoftë kurrfarë sendërtime, edhe sot aplikohet në procesin arsimor në Slloveni. Por, implementimi në praktikën varet nga disa faktorë kyç: “vendosje” e shkrim-leximit mediatik në kategorinë e lëndëve zgjedhore dhe autonomia e shkollave nëse janë nga lista e gjerë e këtyre lëndëve dhe atë do t’ua ofrojnë nxënësve, mësimi i segmenteve parciais nga shkrim-leximi mediatik në lëndë të tjera, gatishmëria e kuadrit arsimor për atë lloj të edukimit, si dhe interesi i nxënësve për përfshirje në aktivitetet e pa obligueshme jashtë shkollore të cilat e përfshijnë edhe shkrim-leximin mediatik. Përveç kësaj, t shumta janë edhe pyetjet dhe dilemat të opinionit vendor dhe shkencor, duke u nisur nga ajo se operohet me termin “edukim” (sipas lëndës zgjedhore *Edukim për mediet*), e jo për “shkrim-leximin”, si dhe kur shkrim-leximi mediatik duhet të mësohet në shkollat, nëse shkrim-leximi mediatik ose digjital, e deri në shkrim-leximin për të gjitha kategoritë e moshave.

“Ajo është shkrim-lexim mediatik dhe ne duhet të mendojmë për atë se në vend nga librat, fëmijët mund të marrin informacione edhe në platforma të tjera. Dhe tani po fillojmë të flasim për shkrim-lexim digjital! Dhe çfarë do të ndodhë pas dhjetë vjetësh kur qytetarët do të kenë ngulitur çipe të instaluara. Për çka do të flasim për atëherë?”¹⁵

Shkrim-leximi mediatik është e domosdoshëm në sistemin arsimor, dhe atë si lëndë e detyrueshme, në vend të Edukimit të deritanishëm për mediet, i cili ishte pikërisht për atë sepse ishte një lëndë zgjedhore nuk vlente për të gjitha shkollat dhe pothuajse 20 vjet nuk është e modernizuar, posaçërisht nëse kihet parasysh se:

“Në vitet e fundit në shkollat nuk ka interes në shkollat për këtë lëndë, ajo është e marginalizuar, ndërsa vëmendja është më tepër e fokusuar ndaj lëndëve që kanë vlera praktike, për shembull, gjuhët e huaja. Në shkrim-leximin mediatik shihet si një lëndë relativisht abstrakte-filozofike që nuk ka avantazhe aplikative.”¹⁶

Por, këtu nuk guxohet të ndalemi dhe edukimi për shkrim-lexim mediatik duhet të përfshijë jo vetëm nxënës, por edhe të gjitha kategoritë e rritura, posaçërisht ato më në moshë të cilat nuk kanë (para)njohje teknologjike si të rinjtë. Me këtë rast, në dilemën se kur të fillojë studimi i kësaj lënde, njohuritë praktike tregojnë se në tre vitet e fundit (klasa e 7, 8 dhe 9) të arsimit fillor është koha kur nxënësit janë në gjendje të perceptojnë përmbajtje të tilla, ndërsa në mënyrë më optimale do të kishte qenë mësimi i tij në arsimin e mesëm. Përballë asaj, pyetja është nëse dhe sa me mësimin e pjesëve të shkrim-leximit mediatik në lëndët e tjera, gjuha Sllovene ose Edukimi Qytetar, mund të arrihen rezultatet e dëshiruara. Në fakt:

“Fëmijët do të shkojnë në teatër e pastaj do të bëjnë një recension të performancës. Por, nuk ka kurrfarë teorie, çka është gazetaria, si funksiono-

15 Intervistë me d-r Sandra Bashiq-Hrvatini, profesore në Fakultetin e studimeve humaniste në Kopër, republika e Sllovenisë.

16 Intervistë me d-r Marko Millosavleviq, profesor i Fakultetit të shkencave shoqërore, në Katedrën e gazetarisë në Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

jnë mediet, mediet dhe demokracia, dallimi në mes medieve komerciale dhe publike. Thelbi është se fëmijët në atë mënyrë nuk do të njihen deri në fund dhe do të ju mungojnë ato pjesë që të mund të përputhen në një tërësi.”¹⁷

Shumë i madh është edhe numri i hulumtimeve në periudhën e kaluar për informatizimin e shkollave, e-kompetencave të arsimtarëve dhe të nxënësve (si operohet me informacionet dhe si zgjidhen problemet), e-materialet, librat elektronik të mësimin, e-tabela shkollore (për shkrim-lexim digjital), pedagogji inovative dhe të tjera, në të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, është përfaqësuar edhe shkrim-leximi mediatic. Në to janë përfshirë edhe arsimtarët edhe nxënësit, përmes seminareve, debeteve, punës nëpër shkolla. Por, duket se:

“Aktivitetet zgjasin për aq kohë sa zgjat projekti. Në momentin kur projektet do të mbarojnë, aktivitetet do të shuhën. Megjithatë, kjo është një bazë e mirë për modernizimin e programeve arsimore, megjithëse nuk bëhet fjalë për një proces të vazhdueshëm. Kur do të fillojë një projekt i ri, mungon edhe ndërlidhja e tij me atë që është bërë paraprakisht.”¹⁸

Në këtë plan, Agjencia për rrjete dhe shërbime të komunikimit (ARRSHK) të Republikës së Sllovenisë nuk ka kurrfarë aktivitete. Kjo fushë u është lënë ministrive dhe organizatave joqeveritare. Prapëseprapë, ata rolin e vet konkretisht e shohin si informim dhe nxitje të shkrim-leximit mediatic. Për atë qëllim:

“Si fazë e parë është krijimi i një ueb-faqe, të ngjashme me portalin e internetit për shkrim-leximin mediatic të Kroacisë fqinje. Gjërat shkojnë ngadalë, hap pas hapi. Problemi, mbi të gjithash, është kapacitetet e dobëta kadrovike dhe kapacitetet financiare me të cilat disponojmë.”¹⁹

Sidoqoftë, sektori joqeveritar është shumë aktiv në shkollat, për çka nuk nevojitet pëlqimi nga Ministria apo Enti për arsim, por përkundrazi, ata e mbështesin punën e tyre. Për nga tematika më shpesh bëhet fjalë për internet bon-ton, dhunë në internet, rreziqet në internet, mbrojtje e privatësisë, përdorimi i rrjeteve sociale, lajmet e rreme. Më shpesh ato janë, punëtori, seminare, klube (gazetareske) të ndryshme që mbështeten mbi bisedën me fëmijët:

“Bisedojmë për problemet e tyre, çka ndodh në internet, u japim këshilla dhe ndihmë. Ata punojnë në shembuj konkret nga praktika, marrin detyra që i prezantojnë dhe mandej diskutojnë për atë. Nënkuptohe, kjo nuk mjafton dhe këto tema do të duhet të jenë pjesë përbërëse e kutikulave shkollore.”²⁰

17 Intervistë me Domen Saviq, udhëheqës i Institutit “Shtetësi D” në Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

18 Intervistë me d-r Fani Nolimal, udhëheqëse e Seksionit për arsim fillor pranë Byrosë për arsim të Republikës së Sllovenisë.

19 Intervistë me Tomazh Gorjanc nga Agjencia për rrjete dhe shërbime komunikuese të Republikës së Sllovenisë.

20 Intervistë me Marko Pushner, Rrjeti për ngritje të vetëdijes për përdorimin e sigurt të internetit të formuar në kuadër të programit të UE për internet të sigurt, Lubjanë.

Por, mbetet problemi me edukimin e kuadrit arsimor. Formalisht, kur reformohej sistemi arsimor, çdo arsimtar kaloi përmes trajnimit, të realizuar përmes një projekti të veçantë, ndërsa kur projekti përfundoi, u shuan edhe këto aktivitete. Nuk ka program për edukim të kuadrit dhe shumë është vështirë dhe shumë është vështirë të mendohet se si do ta mbajë të gjallë atë arsim. Nuk ka as standarde për shkrim-lexim mediatik me leje nga Ministria për arsim. A do të jetë ky studim paralel i Fakultetit për gazetari dhe të Fakultetit Pedagogjik, ku studentët për gazetari në vitin e tretë dhe të katërt praktikën obligative do ta kryenin jo vetëm në mediet, por edhe si kuadër për shkrim-lexim mediatik në shkollat. Nëse në fillim të shkrim-leximit mediatik kishte një numër të madh të ligjëratave, sot ajo realizohet përmes kontakteve të drejtorit të shkollave me individë, ekspertë, më shpesh në baza private.

Gjithashtu, sot pas një periudhe prej 20 vjetësh nga aplikimi i shkrim-leximit mediatik, në Slloveni gjithnjë e më shumë po flitet për shkrim-leximin digjital. Madje mund të thuhet gjithashtu se ajo një prioritet i Qeverisë, gjithashtu edhe në nivel evropian, për të cilin ndahen fonde të rëndësishme për aktivitete kërkimore. Përkatësisht:

“Shkrim-leximi mediatik ndërthuret me teknologjitë informatike. Kështu, ajo që ka të bëjë me shkrim-leximin mediatik në internet bëhet fjalë për kuadrin e shkrim-leximin digjital dhe përvetësimin e kompetencave digjitale.”²¹

Çështja është nëse kjo është një trend në kohën e revolucionit digjital të përkrahur nga industria digjitale, që të gjithë të mësojnë informatikë dhe programim dhe të gjithë “të bëhen programues”. Prandaj, ndërkaq, askush nuk shpjegon, për shembull, çfarë është Fejsbuku, si funksionon, prej ku i ka të gjitha të dhënat. Por në shkollat tanimë ekzistojnë iniciativa për lëndë të veçantë, “Edukata digjitale”, me tre module - shkrim-lexim mediatik, shkrim-lexim digjital dhe mbrojtje e privatësisë dhe të dhënave personale për fëmijët nga klasa e katërt. Por jo në kuptim të përvetësimit të shkathtësive teknike, por se si mund të jemi të sigurt në rrjetin, si të mendosh dhe të vëzhgosh në mënyrë kritike:

“Gjithashtu si shkrim-leximi gjuhësor (i leximit), ne mund të fillojmë edhe me shkrim-leximin digjital dhe ky është obligim i shkollës. Fëmijët vijnë nga mjedise të ndryshme, me prindër me status të ndryshëm social, kanë para-dispozita të ndryshme dhe detyra janë është që atë ta barazojmë. Të gjithë supozojmë se fëmijët dinë çdo gjë, por kjo nuk është kështu, madje disa nuk dinë as ta kyçin kompjuterin. Fëmijët i mësojmë të ndalen në semaforin e kuq, por nuk i mësojmë se çka të bëjnë në rrjetin, si ta përdorin telefonin e mençur celular.”²²

Por, ajo që duket kyç është mungesa e zgjidhjes sistimore për shkrim-leximin mediatik. Ka gjithçka në dokumentet dhe programet, ka shumë ekspertë, mësuesit kanë mundësi të ndjekin seminare dhe ta bëjnë atë. Por, asgjë nuk është e integruar në mënyrë sistimore – “nëse dëshiron mundet, nëse nuk dëshiron, nuk je i detyruar “:

21 Intervistë me m-r Borut Čampelj nga Ministria e arsimit, shkencës dhe sportit të Republikës së Sllovenisë.

22 Intervistë me Barbara Kompjut, drejtore e shkollës filllore “France Bevk” në Lubjanë.

“Këtu lobimi luan rol të madh, posaçërisht lobi natyror-teknik për atë se të gjithë duhet të studiojnë shkencë teknike. Ajo tani është e popullarizuar, në kuptimin se na mungojnë inxhinierë.”²³

Sot fëmijët kanë qasje në mediet dhe teknologjitë mediatike që nuk u përshtaten dhe atyre duhet t’u shpjegohet atyre se çfarë po ndodh. Industria që tërë atë e ka krijuar kurrë nuk niset nga ajo se ata do të jenë përdoruesit më të mëdhenj. Për herë të parë në historinë e njerëzimit, brezi më i vjetër duhet ta mësojë teknologjinë, ndërsa të rinjtë që nga lindja jetojnë me atë. Prandaj, gjithnjë e më tepër janë të zëshme kërkesat e ekspertëve dhe të publikut shkencor për domosdoshmërinë e zhvillimit të “një politike serioze dhe gjithëpërfshirëse të shkrim-leximit mediatik, nëse Sllovenia dëshiron të bëhet shtet i qytetarëve aktivë”. Nuk mjafton promovimi i saj përmes projekteve ose programeve të nxitura nga institucionet akademike dhe publike ose nga organizata joqeveritare në nivel lokal dhe në nacional.²⁴ Në atë drejtim, Propozim strategjia nacionale mediatike e vitit 2016 e Ministrisë së kulturës i përkushton një kapitull të veçantë shkrim-leximit mediatik, fillimisht e ndërlidhur me kurikulat shkollore, dhe theksohet se shkrim-leximi mediatik dhe digjital, në vend si fakultativ, duhet të jetë lëndë obligueshme në arsimin, si dhe vendosja e sistemit të edukimit të vazhdueshëm mediatik të shfrytëzuesve të medieeve, përfshirë edhe të rriturit, botuesit, krijuesit dhe provajderët e onlajn shërbimeve si palë kryesore të interesuara.²⁵ Këto udhëzime janë përkthyer edhe në Strategjinë më të re për zhvillim të medieeve në Republikën e Sllovenisë deri në vitin 2024 (e Ministrisë së Arsimit), duke theksuar nevojën për vënien e arsimit mediatik si lëndë e detyrueshme në arsimin dhe zhvillimin e një sistemi të arsimit mediatik për të rriturit. Gjithashtu, për shkak të përhapjes së medieeve ose ueb-faqeve të cilat sigurojnë një spektër të gjerë të informacioneve, video-përmbajtjeve, klipeve, ueb-rrjeteve, nevojitet që të sigurohet që përdoruesit të përvetësojnë dituri përkatëse dhe aftësi për pranim kritik të informacioneve, vlerësimi i tyre dhe formimi aktiv në raport me botën, me shoqërinë dhe me veten.²⁶

Duket se do të vlen të përmendet Strategjia për zhvillimin e programit nacional të arsimit filmik të Ministrisë së kulturës - 2016, ku propozohet përfshirja e përmbajtjeve filmike dhe audio-vizuale në planet programore dhe në procesin arsimor-edukativ. Në këto suaza, krahas një lënde të posaçme zgjedhore e Edukimit për filmin (për shkollat fillore dhe të mesme), propozohet edhe ripërtëritje dhe përfshirje e këtyre përmbajtjeve në lëndën e Edukimit mediatik. Strategjia thekson se edukimi i filmit dhe mediatik i kanë të njëjtat qëllime për përfitimin e njohurive të nevojshme për edukimin e një individi të aftë për t’u integruar në jetën bashkëkohore shoqërore. Përkatësisht, “në kohën e teknologjisë digjitale e cila në thelb ndikon në mënyrë thelbësore në mënyrat e distribuimit të filmit, veprave audiovizuale dhe shërbimeve mediatike, është e

23 Intervistë me Gregor Delej, drejtor i gjimnazit Celje në Celje të Sllovenisë.

24 Shih më tepër në: <https://rm.coe.int/media-literacy-mapping-report-en-final-pdf/1680783500>

25 Shih më tepër në: http://www.mk.gov.si/fileadmin/mk.gov.si/pageuploads/Ministrstvo/Fotogalerija/2016/junij/MED-STRAT_Strategjia5-2_26.5.2016-L.pdf

26 Shih: http://www.mk.gov.si/fileadmin/mk.gov.si/pageuploads/Ministrstvo/Fotogalerija/2016/junij/MED-STRATStrategjia_razvoja_medijev_v_Republiki_Sloveniji_do_leta_2024_-_v_1.0_junij_2016.pdf

pamundur të flitet për shkrim-lexim mediatik nëse ai nuk përfshin njohuri bazike dhe kuptim të plotë të ligjshmërive të gjuhës së filmit²⁷. Së fundmi mbetet të shihet nëse, në përputhje me përcaktimet strategjike, lënda zgjedhore Arsimi mediatik do të hyjë në grupin e lëndëve të detyrueshme në procesin arsimor me një program të ri, të modernizuar, dhe nëse dhe si do të realizohet shkrim-leximi mediatik për kategoritë e tjera të qytetarëve, para së gjithash për të rriturit.

27 Shih më tepër në "Strategjia razvoja nacionalnega programa filmske vzgoje" 2016 të Ministrisë së Republikës së Sllovenisë, http://www.mk.gov.si/si/zakonodaja_in_dokumenti/sprejete_strategije_in_politike/

4.

Rregullativa për edukim mediatik në Maqedoni

KORNIZA NORMATIVE

Në legjislacionin e Maqedonisë në sferën e arsimit, kulturës dhe medieve ende nuk është i njohur termi “shkrim-lexim mediatik”, që nuk do të thotë se aspektet e ndryshme të shkrim-leximit mediatik dhe informatik nuk janë të përfshira me vendime ligjore. Përballë asaj, fusha të caktuara, siç janë liri e shprehjes dhe liria e medieve, sjellja etike e gazetarëve dhe të redaktorëve, mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet jo përkatëse ose mbrojtje publikut nuk janë të shënuara në mënyrë eksplicite si pjesë të shkrim-leximit mediatik, por janë të rregulluara me dispozita të veçanta ligjore ose akte nënligjore. Në çka konkretisht udhëzojnë ligjet?

Ligji për arsim fillor, i miratuar në vitin 1995, deri sot ka pësuar ndryshime të shumta (më së shumti në vitet 2010, 2011, 2014, 2015), ndërsa të fundit janë në prill të këtij viti (mënjanimi i testimit ekstern të nxënësve). Njëri nga ndryshimet kyç është aplikimi i edukimit të obligueshëm nëntëvjeçar (në vitin 2007), pas së cilës do të fillojnë reformat në planet dhe programet arsimore. Libra mësimi të shumta do të pësojnë revizion (për shembull, librat mësimore për gjuhë amtare, shoqëri), ndërsa do të aplikohen edhe lëndë të reja obligative (si Puna me kompjuterë dhe baza të programimit, Informatika, Edukimi qytetar) dhe zgjedhore (si Etikë e religjioneve, Njohuri për religjionet, Kulturë klasike në civilizimin evropian). Midis tyre, ndër të tjerat, si njësi të veçanta mediatike do të përfshihen mediet, kultura e medias, onllajn jeta dhe interneti me qëllime, përmbajtje, koncepte dhe nocione të përcaktuara qartë. Prandaj, edhe pse shkrim-leximi i medias nuk theksohet në mënyrë eksplicite dhe ligjore, ajo në fakt bëhet pjesë e të gjithë procesit arsimor. Ajo përputhet me një nga modelet e Mastermanit për përfshirje të arsimit mediatik në shkollat fillore - shkrim-leximi mediatik si pjesë e disa lëndëve të ndryshme mësimore,¹ përkatësisht modeli i formës ndërkulikulare të integritimit të studimeve mediatike në disa lëndë të ndryshme. E cila në mënyrë dominante praktikohet në nivel evropian.²

Një akt tjetër normativ që i referohet shkrim-leximit mediatik dhe që ka të bëjë drejtpërdrejt me popullatën e nxënësve të shkollave fillore është Ligji për shërbimet audio dhe audiovizuale (nga viti 2013). Në të nuk ka definicion apo sqarim se çfarë nënkuptohet me shkrim-lexim mediatik, siç është bërë (neni 3) për shprehje të tjera të paraqitura në ligjin (për shembull, për një program audiovizual, për shërbim mediatik audiovizual, ofrues të shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale, producent i parvarur, program i prodhimit të vet, ritransmetimi i shërbimeve programore, reklamimi, sponsorizimi, teleshoppingu dhe të ngjashme. Prapëseprapë, shkrim-leximi mediatik është i pranishëm në disa nene të Ligjit. Fillimisht përmendet në nenin 2 ku janë definuar qëllimet e Ligjit, siç është zhvillimi i shërbimeve audio dhe audiovizuale mediatike,

1 Masterman flet për katër lloje të përfshirjes së edukimit mediatik në shkollat fillore: edukimi mediatik si lëndë e specializuar, edukimi mediatik si pjesë përbërëse e tërë kutikulës së lëndës gjuhë amtare, pjesë të caktuara të edukimit mediatik të përfshira në lëndë të ndryshme (gjuhë amtare, histori, gjeografi) dhe edukim mediatik si aktivitet i lirë në shkollën.

2 Më tepër në hulumtimin e EMEDUS për edukimin formal mediatik në Evropë nga viti 2014, <https://eavi.eu/wp-content/uploads/2017/02/Media-Education-in-European-Schools-2.pdf>

zhvillimi i produksionit të pavarur, nxitje, avancim dhe mbrojtje e identitetit kulturor, gjuhës dhe traditat e komuniteteve në vend, inkurajim i kulturave të dialogut publik mes qytetarëve, nxitje e krijimtarisë, edukimit dhe zhvillimit shkencor, mbrojtje e interesave të përdoruesve sidomos të personave të mitur ... ndërsa veçanërisht theksohet edhe sigurimi i “zhvillimit të shkrim-leximit mediatik”. Më tej, Ligji përcakton se Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike është trup i cili kujdeset për “nxitje të shkrim-leximit mediatik” (neni 6), “ndërmerr aktivitete për nxitje të shkrim-leximit mediatik” dhe për atë se “bashkëpunon me organizata joqeveritare dhe palë të tjera të interesuara dhe të njëjtave publikon në ueb faqen e vet” (neni 26). Obligimet në lidhje me shkrim-leximin mediatik ka edhe servisi publik radio-difuziv (radio-televizioni i Maqedonisë) në programet dhe serviset programore të cilat i transmeton. Përkatësisht, ai midis të tjerave, është i obliguar të “krijojë dhe të transmetojë programe që kanë të bëjnë me nxitje të shkrim-leximit mediatik “ (neni 110).

KORNIZË STRATEGJIKE

Shumë më tepër elementë të mëtejshëm mbi nevojën dhe domosdonë e nxitjes së promovimit të shkrim-leximit mediatik në sistemin arsimor mund të gjenden në dokumentet strategjike (strategjitë, programet nacionale) të institucioneve kompetente në vend, por theksi është më tepër është në shkrim-leximin informatik dhe digjital.

Ministria e arsimit dhe shkencës, në Programin nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015³, e thekson rëndësinë e *shkrim-leximit kompjuterik* të të rinjve dhe të rriturve, përkatësisht njohjen dhe punën me teknologjinë informatike-kompjuterike (TIK) si pjesë esenciale nga kompetencave të të rinjve dhe të rriturve dhe kusht për manifestimin e tyre efikas në sferën e punës dhe jetës shoqëro-politike. Në kapitullin “Programi për zhvillimin e TIK-ut në arsimin”, theksohen udhëzimet për zhvillim të arsimit në funksion të mbështetjes së shoqërisë informatike, përkatësisht përsosjen teknike (kompjuterike) të institucioneve arsimore, përsosjen profesionale (edukimin) e stafit mësimdhënës i cili aplikon teknologji informatike për realizimin e mësimdhënies me përvetësimin dhe zbatimin e TIK si mjet për kryerjen e detyrave punuese. Me këtë rast, është shënuar se mbajtja e hapit me trendet botërore e imponoi nevojën për shfrytëzimin e mjeteve të TIK jo vetëm në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, por edhe në periudhën parashkollore, për të mos i humbur mundësitë e çmuara të cilat i ofron kjo periudhë e zhvillimit të njeriut. Përpejket lëvizin në drejtim të *revidimit të programeve arsimore në varësi nga disiplinat arsimore, dizajnimi i programeve arsimore të drejtuara ndaj një qëllimi, si dhe bazë për gatishmëri efektive të fëmijëve/të rinjve për zhvillimin e aftësive për mendim të pavarur krijues dhe kritik dhe mendimit si dhe të jetës cilësore.*

Ministria e Shoqërisë informatike dhe të administratës ka përgatitur dy strategji që drejtpërdrejt lidhen me përfitimet nga përfshirja e teknologjive informatike-komunikuese në shkollat fillore dhe të mesme. E para është “Strategjia nacionale për

³ Shih: <http://fvm.ukim.edu.mk/documents/Nacionalna-programa-za-razvoj-na-obrazovaniето-vo-Republika-Makedonija-2005-2015.pdf>

zhvillim të e-përmbajtjeve 2010 – 2015⁴, të orientuar drejt modernizimit të procesit arsimor dhe përmirësimit të cilësisë së arsimit, para së gjithash, përmes integritit të teknologjive digjitale në mësimdhënien. Në strategjinë, së pari theksohet se: “Arsimi bashkëkohor u mundëson nxënësve të përfitojnë dy shkrim-lexime informatike. “Shkrim-leximi i parë” ka të bëjë me TIK dituritë të nxënësve ndërsa “shkrim-leximi i dytë” i referohet aftësisë së personit për ta rritur efektivitetin dhe produktivitetin e vet në punë duke përdorur TIK teknologji.” Në atë drejtim, në planin e zhvillimit konkretisht është definuar metodologjia për përzgjedhje të lëndëve të përfshira me e-përmbajtje nga fusha natyrore-matematikore, shoqërore-humaniste dhe mësimi i gjuhëve për arsimin fillor (si dhe për të mesmin) dhe janë theksuar lëndët gjuhë amtare (Maqedonisht, Shqip, Turqisht dhe Serbisht), Njohje e ambientit, Histori, Gjeografi, Muzikë dhe edukimi figurativ. Gjithashtu, është propozuar një kornizë - kritere për përzgjedhjen efikase të përmbajtjeve mësimore për të cilat do të hartohen e-përmbajtje, si dhe një përshkrim i hollësishëm i procesit të hartimit të e-kornizës (specifikimet teknike, specifikimet për përgatitjen e skenarëve, përcjellje e rrjedhës së hartimit, kritere për pranim të produkteve përfundimtare). Strategjia i vë në pah faktorët kryesorë për realizim efikas dhe zhvillim të e-përmbajtjeve, posaçërisht të kuadrit mësimor për përdorimin dhe zbatimin e drejtë të përmbajtjeve digjitale në realizimin e programit mësimor.

Në dokumentin e dytë, Strategjinë nacionale për e-përfshirje 2011-2014⁵, bartës i së cilës është Ministria e arsimit dhe e shkencës, apostrofohet rëndësia e *shkrim-leximit digjital*, duke i përcjellë rekomandimet për shoqëri informatike të Unionit Evropian, posaçërisht të strategjisë evropiane Evropa 2020, për rëndësinë e edukimit të qytetarëve evropian për përdorimin e TIK dhe të medieve digjitale, si dhe për tërheqje të rinjve që ti përdorin këto teknologji në procesin arsimor. Qëllimi themelor i Strategjisë është “zvogëlimi i hendekut digjital dhe krijimi i shoqërisë inkluzive informatike për të gjithë qytetarët, duke siguruar përdorim të rritur dhe më cilësore të TIK në jetën e përditshme të qytetarëve, kushte të lehtësuara për qasje në TIK dhe rritje të shkathtësive të qytetarëve”. Prioriteti Kyç i Strategjisë është “rritje e shkrim-leximit të përgjithshëm digjital dhe i kompetencave të qytetarëve”, që përfshin masa për digjitalizimi të procesit formal arsimor, veçanërisht në arsimin fillor dhe të mesëm (kompjuterizimi dhe futja e internetit në shkolla, ofrimi i përmbajtjeve elektronike në dispozicion në internet dhe aplikimi i TIK mjeteve në mësimdhënie) dhe rrumbullakimi i edukimit i personave të rritur, të papunëve dhe personave me invaliditet (përmes kurseve për punë me kompjuterë, internet, postë elektronike....).

Dokumenti në të cilin për herë të parë hapet çështja e shkrim-leximit mediatic është Projekt-strategjia për zhvillim të veprimtarisë radiodifuzive në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2013-2017 (dokument i cili nuk u miratua nga Kuvendi i RM)⁶, të Këshillit për veprimtari radiodifuzive (sot Agjenci për shërbime audio dhe audiovizuale). Propozim-strategjia i kushton një kapitull shkrim-leximit mediatic dhe qartë e thekson nevojën për promovimin e saj si interes më të madh të shoqërisë së Maqedonisë.

4 Shih: http://www.mio.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/strategjia_e-sodrzini_2.pdf

5 Shih: http://www.mio.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/Strategjia_za_e-vklucvanje.pdf

6 Shih: <http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Predlog-Strategjia-i-Akciski-plan.pdf>

donisë, proces në të cilin duhet të përfshihen institucionet arsimore me mekanizma për kontrollim të efekteve të arsimit mediatic në programet arsimore, profesionistët mediatic me zhvillim të kodeve vetë-rregulluese të ndërlidhura me respektimin e standardeve profesionale për rritje të përgjegjësisë së tyre gjatë krijimit të prodhimeve mediatiche, trupat rregullatore në fushën mediatiche me zhvillimin e programeve të veçanta me më tepër aktivitete të ndërlidhura me shkrim-leximin mediatic, përfaqësues të shoqërisë civile me iniciativa dhe projekte të ndryshme, si dhe institucionet shkencore me hulumtimin në këtë fushë. Në planin aksionar, Strategjia propozon përfshirje të konceptit të shkrim-leximit mediatic në arsimin, me zbatimin e hulumtimeve të efekteve nga arsimit mediatic në programet arsimore dhe hartimin e hartimit për zhvillim të mëtejshëm.

“Strategjia më e re për zhvillim të arsimit për vitet 2018-2025 dhe plani aksionar”⁷ i Ministrisë së arsimit dhe të shkencës, infrastruktura e sistemit arsimor, kapacitetet e resurseve njerëzore, si dhe ndaj “zhvillimit të kompetencave gjenerike dhe kompetencat kyçe të nxënësve në mënyrë që ato të zhvillohen në subjekte kritike, pjesëmarrës aktiv dhe relevant në jetën shoqërore”. Për atë, theksohet, është e nevojshëm zhvillimi i hapave dhe të mjeteve për inkorporim të: *kompetencave gjenerike* – për mendim kritik dhe marrje të vendimeve të argumentuara, aftësi për zgjidhje të problemeve dhe aplikimin e diturive në situata reale praktike, për shkathtësi intern-personale dhe infra-personale socio-emocionale; *si dhe kompetencat kyçe* – të mësohet se si të mësohet, inovativitet dhe sipërmarrësi, përgjegjësi qytetare dhe shoqërore, vetëdije dhe shprehje kulturore, në të njëjtën kohë me kompetencat kyçe për komunikim në gjuhën amtare dhe të huaj, për matematikë, shkencë dhe teknologji natyrore dhe kompetencë digjitale. Padyshim, kompetencat të cilat përvetësohen edhe përmes arsimit mediatic, por ajo nuk është e shënuar në strategjinë. Vëmendja edhe kësaj radhe është e orientuar drejt *shkrim-leximit informatik*. Kështu, në qëllimet, krahas racionalizimit të programeve dhe programeve arsimore (përkatësisht ndërlidhje e temave në programet e integruara), përshtatje e programeve arsimore mësimore për moshat e nxënësve, avancimi dhe përshtatja e instrumenteve për sigurim të cilësisë me të cilën në qendër të vëmendjes është nxënësi dhe interesi i tij më i mirë, zbatimi konsekuent i konceptit të mësimin inklusiv dhe multikulturor me fokus mbi vlerat demokratike, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, respektimin e dallimeve..., theksohet nevoja e *intensifikimit të zbatimit të TIK në arsimin përmes krijimit të e-portalit dhe sistemit për menaxhim me mësimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të kuadrit* për përdorimin e teknologjive të reja dhe TIK mjeteve në arsimin. Në atë kontekst është shënuar se pa marrë parasysh se për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme janë të siguruara kompjuterë personal të qasshëm për të gjithë nxënësit, zbatimi i TIK në procesin arsimor nuk është efektiv në mënyrë të mjaftueshme. Përkatësisht, mungojnë standarde për shfrytëzim të TIK në procesin arsimor, ndërsa të gjithë arsimtarët nuk janë të trajnuar mirë. Softueri që është në dispozicion nuk është i pa përshtatshëm që ti kënaq nevojat në vazhdë e sipër, ndërsa për realizim të përmbajtjeve të shumta TIK nuk është e nevojshme, por përkundrazi kompjuterët më tepër pengojnë, e okupojnë hapësirën dhe e vështirësojnë komunikimin në relacionin arsimtar - nxënës. Por, me rëndësi është të theksohet se një nga qëllimet e Strategjisë është edhe krijimi i bazave për hartimin dhe “zhvillimin e

7 Shih: <http://mrk.mk/wp-content/uploads/2018/10/Strategjia-za-obrazovanie-MAK-WEB.pdf>

reformës integrale në tërësi që do ta integrojë arsimin e gjithëmbarshtëm”, nga arsimit parashkollor deri në atë të lartë, si një proces dhe mundësi për të mësuarin gjatë gjithë jetës, në të cilën në mënyrë logjike dhe të një pas njëshme ndërlihen nivelet e arsimit.

Ndërkohë, Ministria e shoqërisë informatike dhe e administratës ka sjellë strategji të shumta kombëtare dhe plane veprimi, por fokusi nuk është më në teknologjitë informatike dhe të komunikimit. Gjithashtu duhet të përmendet Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, përkatësisht Projekt - Strategjia për zhvillim të veprimtarisë radiodifuzive në Republikën e Maqedonisë në vitet 2018-2022 (e cila ende nuk është miratuar), e orientuar ndaj gjashtë fusha kyç: profesionalizmit dhe pavarësisë redaktuese të medieve, mbrojtja dhe zhvillimi i pluralizmit të medieve, mbrojtje e të drejtave të njeriut në media, kornizës rregullatore që e mundëson zhvillimin e medias, sigurim të kushteve për rritje dhe zhvillim të tregut dhe konkurrencës dhe zhvillim të shkrim-leximit mediatik. Në fushën e shkrim-leximit mediatik, theksi do të jetë mbi inkurajimin e pranimit kritik dhe në kuptimin përmbajtjes mediatike, si dhe mbi rritjen e rolit të medieve në zhvillimin e shkrim-leximit mediatik.

5.

Shkrim-leximi mediatik në programet mësimore në arsimin fillor në Maqedoni

Termi shkrim-leximi mediatic” nuk ekziston në asnjë program mësimor të cilës do qoftë lëndë që mësohet në arsimin fillor. Por kjo nuk do të thotë se nxënësit në arsimin fillor nuk mësojnë për mediet, për rolin e tyre në shoqërinë, për të drejtën për liri të shprehjes dhe informim, llojet e medieve dhe ngjashëm.

Pyetje qenësore është çka mësojnë dhe cilat janë rezultatet nga ky mësim?

Njëlloj si në përpjekjet e tjera për përcaktim të kriterëve për analizë të njohurive mediatiche në programet arsimore në arsimin fillor (siç për shembull në Studimin Evropian të shkrim-leximit mediatic dhe edukimit EMEDUS¹ në të cilin analizohen programet mësimore në arsimin fillor në 27 vende të Evropës), mandej debati për përcaktimin e qasjes metodologjike dhe kornizës konceptuale në të cilat do të mbështetet ky lloji i analizës², edhe në këtë hulumtim u hap dilema se cilat segmente dhe aspekte nga arsimi fillor nacional duhet të interpretohen në kuptimin e shkrim-leximit mediatic.

Prapëseprapë, pikënisje ishte korniza konceptuale për zhvillimin e kriterëve për vlerësim të shkrim-leximit të tyre mediatic, që e zhvilloi EAVI³ në vitin 2010 dhe Grupi i Eksperteve për shkrim-lexim mediatic që e themeloi Komisioni Evropian. Sipas studimit të KE për vlerësim të niveleve për shkrim-leximin mediatic, koncepti për shkrim-leximin mediatic ka dy dimensione: (1) kompetenca individuale dhe (2) faktorë të ambientit ku jeton. Kompetencat individuale definojnë si “kapacitet individual për aplikimin e shkathtësive të caktuara... që shfrytëzojnë një vëllim të gjerë të aftësive dhe përfshijnë nivele në rritje e sipër të vetëdijes, kapacitet për mendim kritik dhe aftësi për prodhimin dhe transmetimin e mesazhit “⁴.

Nga ana tjetër, **faktorët e mjedisit** paraqesin “pako e faktorëve kontekstual (të cilat reflektohen në kompetencat individuale), që ndikon në vëllimin e gjerë të edukimit mediatic, përfshirë edhe qasshmërinë informatike, politikën e medieve dhe rolet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në komunitetin mediatic⁵.”

1 Raporti për edukim formal mediatic në shkollat në 27 vende të Unionit Evropian, viti 2014. Shih më tepër në <https://eavi.eu/wp-content/uploads/2017/02/Media-Education-in-European-Schools-2.pdf>

2 Kris Vorsnop në “Shkrim-leximin mediatic përmes mendimit kritik “ i numëron përpjekjet më të rëndësishme për përcaktim të kornizës konceptuale për edukim mediatic. Shih më tepër në https://depts.washington.edu/nwmedia/sections/nw_center/curriculum_docs/stud_combine.pdf

3 Organizata civile për shkrim-lexim mediatic nga Brukseli, www.eavi.eu. Më tepër për strukturën e kriterëve për vlerësim të shkrim-leximit mediatic, shih në <https://eavi.eu/wp-content/uploads/2017/08/assessing.pdf>

4 Raport përfundimtar për Studimin “Kritere për vlerësim të niveleve për shkrim-lexim mediatic”, faq. 7. E qasshme në: http://ec.europa.eu/culture/media/media-content/media-literacy/studies/eavi_study_assess_crit_media_lit_levels_europe_finrep.pdf

Ibidem, faq.7.

5 Ibidem.

Edukimi mediatik	Prania e edukimit mediatic në planet dhe programet mësimore
	Mënyra e trajtimit të edukimit mediatic në planet dhe programet mësimore
	Edukatë e profesorëve
	Materiale didaktike
	Prani e edukimit mediatic në strategjitë nacionale për edukim
Politikë mediatike	Prania e shkrim-leximit mediatic në aktet ligjore dhe nënligjore
	Ekzistimi dhe mandati i trupave rregullatore
	Aktivitete të trupave rregullatore
	Ekzistencë dhe aktivitete të trupave vetë-rregullatore
Industri mediatike	Aktivitete të gazetave ditore
	Aktivitete të stacioneve televizive dhe radio-stacioneve
	Aktivitete të festivaleve filmike
	Aktivitete të kompanive telefonike dhe provajderëve shërbimeve të internetit
	Aktivitete të industrisë së teknologjive informatike
Spektori civil	Ekzistimi i organizatave civile të cilat merren me avancimin e shkrim-leximit mediatic
	Aktivitete të organizatave civile në fushën e shkrim-leximit mediatic
	Bashkëpunim me mediet

Tabela 1 – Pasqyrë e faktorëve të ambientit ku jetojnë që ndikojnë mbi shkrim-leximin e tyre mediatic

Gjatë përcaktimit të trajtimit të shkrim-leximit në arsimin në Maqedoni, u nis nga çështjet vijuese:

1. Çfarë është prania dhe trajtimi i edukimit mediatic në planet dhe programet mësimore?
2. Cilat materiale didaktike përdoren në mësimin?
3. Si është i rregulluar statusi i profesorëve për këtë fushë?
4. Çfarë është prania e edukimit mediatic në strategjitë nacionale për arsim

Duke pasur parasysh se gjatë analizës së programeve arsimore dhe zbatimi i tyre në praktikë është e ndërlidhur me përdorimin e mjeteve didaktike të ndryshme, të dyja çështjet janë sublimuar në nën-pikën 5.1.

5.1. Çfarë është prania dhe trajtimi i edukimit mediatic në planet dhe programet arsimore

Në bazë të planeve dhe programeve mësimore të qasshme në ueb faqen e Byrosë për zhvillim të arsimit www.bro.gov.mk, si dhe në bazë të diskutimeve me arsimtarët nga fokus grupet në tetë rajonet planore (Lindor, Verilindor, të Pollogut, të Pellagonisë, të Shkupit, Juglindor, Jugperëndimor dhe të Vardarit), analizë e rregullave që vlejné dhe të dokumenteve relevante, konkluzioni fillestar është se sistemi arsimor hyn në modelin ndër-kurikular të edukimit mediatic. Kjo do të thotë se ekziston lëndë

e cila i është dedikuar ekskluzivisht vetëm shkrim-leximit mediatic. Ka pjesë nga kjo fushe që mësohet në më shumë lëndë, në të gjitha vitet e arsimit fillor. Më së shpeshti ajo është në lëndët vijuese, edhe pse në lëndët e tjera (të detyrueshme ose zgjedhore), trajtohen tema për mediet në aspekte të ndryshme.

- **Gjuha amtare dhe letërsia** (në të gjitha gjuhët në realizohet mësimi në arsimin fillor: maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht)⁶ nga klasa e parë deri të nëntën.⁷
- **Shkathtësi jetësore** në të tria periudhat zhvillimore (nga klasa e parë deri te e treta, nga klasa e katërt deri te e gjashta dhe nga klasa e shtatë deri te e nënta),
- **Punë me kompjuterë dhe baza të programimit** në klasë të tretë, e katërt dhe e pestë,
- **Shoqëri** në klasën e katërt,
- **Informatikë dhe baza të programimi (lëndë zgjedhore)** në klasë të shtatë dhe të tetë,
- **Edukimi civil** për klasën e tetë (programi i ri) dhe Edukimi qytetar për klasën e nëntë (programi i vjetër).

Gjuhë amtare. Në sistemin tonë arsimor nuk përdoret termi “shkrim-leximi mediatic”, por prandaj në lëndën *Gjuhë amtare*, në fushën programore “Kultura mediaticke” gjatë të gjithë viteve dhe periudhave të zhvillimit janë mësuar aspekte të ndryshme të medieeve në shoqëri, më shpesh me rekomandim që të ndahen 10-12 orë (nga 144 - 180 orë në nivel vjetor, në varësi për cilin departament bëhet fjalë)⁸. Kjo do të thotë se në këtë lëndë, në të cilën nxënësit më së shpeshti i studiojnë llojet e medieeve (radio, televizion, shtyp, gazeta onlajn), specifikat e përmbajtjeve dhe shprehjeve të ndryshme mediaticke (radio drama, emisione televizive, film, dramë etj.) dhe programe (informative, argëtuese, edukative) janë të dedikuara rreth 5-7% nga të gjitha programet për Gjuhën amtare dhe letërsi. Në varësi se për cilën periudhë zhvillimore bëhet fjalë dhe për cilën klasë, BZHA ka vendosur edhe qëllime të ndryshme, përmbajtje, nocione, aktivitete dhe metoda. Me këtë rast, rekomandimi kyç didaktik i BZHA për arsimtarët është që të zbatojnë program të integruar i cili do ta kryqëzojë përpunimin e temës që është e përbashkët për dy ose më tepër lëndë (për shembull, nxënësit të bëjnë lajm ose raport për ngjarje në lëndën Histori).

Ajo që mungon në programet arsimore është lidhja e qëllimeve të dhëna me rezultatet konkrete të mësimi (si për shembull në programin e ri për Edukim qytetar për klasë të tetë në arsimin nëntëvjeçar për vitin shkollor 2018/2019), në të cilën insistohet në Strategjinë për arsim të viteve 2018-2025 për atë se sa janë komplementar me kompetencat e parapara me Ligjin për kornizën nacionale për kualifikime nga viti

6 Sipas “Strategjisë për arsim të viteve 2018-2025“ në vend ka 347 shkolla fillore (rreth 1.100 përfshirë edhe ato rajonale). Nga viti 2010 është aplikuar mësim eksperimental në gjuhën boshnjake që mund të zbatohet në shkollat psi të sigurohen kushte për realizimin e saj.

7 Librat për të njëjtat lëndë të gjuhëve të ndryshme nuk janë identike, por përmbajtja e ndjek programin arsimor.

8 Plan programor për arsim nëntëvjeçar fillor për vitin shkollor 2018-2019, BZHA, i qasshëm në: <http://bro.gov.mk/docs/nastavniplanovi/nastaven%20plan%20devetgodishno%202018%20-2019.pdf>

2016. Kjo në masë të madhe ka të bëjë me faktin që programet ekzistuese mësimore për Gjuhë amtare dhe letërsi janë miratuara para rreth 10 vitesh dhe shumë pak, ose aspak nuk janë të azhurnuara.

Në raport me gjuhët e ndryshme në të cilat zhvillohet mësimi, ideja e BZHA është:

Fusha programore “Kultura mediatike” në lëndën Gjuha amtare

Në *klasën e parë* nxënësit njihen me llojet e ndryshme të emisioneve (televizion, radio), lloje të filmave të animuar (me kukulla dhe të animuar), filma dhe seriale për fëmijë, mandej përfitojnë njohuri elementare për teatër dhe artin e dramës, njihen me revistat e fëmijëve, bibliotekën.

Të ngjashme janë edhe objektivat dhe përmbajtja edhe në *klasën e dytë* (inkurajohet ndjekja selektive e përmbajtjeve televizive, inkurajohen që të shfaqet interes në ndjekjen e shtypit për fëmijë (revista dhe gazeta). Në *klasën e tretë* vëhet theks në radion si medium, dëgjohen radio emisione dhe emisione televizive për tu inkurajuar që të rrëfehët për ngjarjet dhe personazhet. Në këtë program mësimor është paraparë edhe kërkimi në internet.

“Shkojmë fillimisht në bibliotekë, mandej shikojmë TV emisione, emisione dokumentare, filma. Dëgjojmë radio drama për fëmijë që i kam në arkivin tim.”⁹

„Shikojmë “Përralla popullore maqedonase”, ndërsa disa lektyra i shohim të filmuara dhe diskutojmë për dallimet. Më vështirë shkon me medien e shtypur për shkak se më herët në shtëpi janë lexuar gazeta, por sot jo. Fëmijët nuk kanë nga kush të mësojnë lexim të gazetave.”¹⁰

Në *klasën e katërt* qëllimet dhe përmbajtjet në “Kulturën mediatike” janë në nivel më të lartë duke pritur nga nxënësit “që të dallojnë lloje të emisioneve televizive (arsimore, shkencore-të popullarizuar, emisione për fëmijë), dhe në mënyrë të pavarur të përdorin informacione nga shtypi për fëmijë dhe atë të përditshëm. Ajo që është karakteristike, është se në këtë klasë, mediet mësohen edhe në lëndën Shoqëri në të cilën nxënësit duhet ta kuptojnë lidhjen e tyre me shoqërinë përmes mënyrave të ndryshme të informimit. Si një propozim i aktivitete BZHA rekomandon që në orët të lexohen revista, përcjellje të radios, të emisioneve dokumentare, marrje të informacioneve themelore dhe biseda rreth tyre, hulumtimi mbi anët pozitive dhe negative nga përdorimi i gazetës, radios, televizionit dhe internetit.

9 Fragment nga fokus grupi me arsimtarë nga Shtipi, 21.11.2018 .

10 Fragment nga fokus grupi me arsimtarë nga Kumanovë, 31.10.2018 .

“Para ndonjë viti e vizituam shtëpinë botuese “Prosvetno dello” dhe atje pamë se si përpunohet një gazetë, çfarë është redaktor, çfarë është gazetar, çfarë është autor. Dhe kur e punova këtë temë e bëra ndarjen e fëmijëve në dy grupe. Në revistën “Drugarçe” ka faqe matematikore, faqe për gjuhë dhe kështu u ndanë edhe fëmijët. Mandej bënë gazetë të vetën i dhanë një emër dhe e bënë si revistë të klasës. Vjet, ndërkaq, në lëndën “Gjuha maqedonase” në shprehjen dhe krijimin, nxënësit duhej të bëjnë raport për diçka kështu që edhe vetë shfaqën dëshirë të jenë në rolin e gazetarëve. Unë i shtyva të raportojnë nga vendi i ngjarjes, drejtpërdrejtë. Kjo prapëseprapë u bë si një prezantim televiziv, dhe ju kërkova që të njëjtën ta kenë edhe në formë të shkruar. Kjo u dukej interesant edhe nxënësve të klasës së pestë.”¹¹

Në klasën e pestë nxënësit mësojnë që ta dallojnë radhitjen e ngjarjeve në filmin dhe shfaqen teatrore, të njihen me nocionet e skenografisë dhe kostumografisë në film dhe shfaqen teatrore (për çka inkurajon, si e përjetojnë), të bisedojnë për muzikën në filmin.

Në klasën e gjashtë, synohet që nxënësit të jenë në gjendje ti emërtojnë proceset në krijimin e librit; të dallojnë rubrika në gazeta dhe revista, të dallojnë lloje të medieeve: elektronike dhe të shtypura, ta njohin rolin e regjisorit, aktorit, kostumografit dhe skenografit; të dallojnë se çfarë është aktor dhe artist; ta dinë rolin e bibliotekës së medieeve. Rekomandimi nga BZHA për vizitë të shfaqjes teatrore është e zbatuar shpesh në mësimin, shpesh herë e përshtatur sipas mundësive dhe të angazhimit personal të arsimtarëve.

“Te ne në SHF “Kiril Pejçinoviç” në Tearcë salla sportive është e pajisur mirë, kështu që ndodh që atje të luhet shfaqja dhe hyrja të jetë falas. Fëmijët mezi presin që të ndodhë një gjë e tillë. Ka shumë projekte, madje vijnë edhe aktorë nga Shkupi.”¹²

Si grup i synimit në periudhën zhvillimore nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë, midis të tjerave, bëhen përpjekje “nxënësi/nxënësja të aftësohet për interpretim dhe vlerësim të produksionit letrar, skenik, filmik, televiziv dhe forma të tjera mediatike; si dhe “të përshtatet për aplikimin e informacioneve deri te të cilat arrihet përmes TKI “.

Prandaj, në klasën e shtatë, nxënësi/nxënësja pritet të “bëjë dallim midis llojeve të filmave sipas dedikimit dhe përmbajtjes”; “të dihet në mënyrë koncize të rrëfëhet përmbajtja e një filmi të cilit do qoftë lloj”; “ti kuptojnë teknikat dhe periudhat e zhvillimit të filmit vizatimor dhe shfaqjes teatrore të kukullave”; “ti vërejnë karakteristikat edhe negative edhe pozitive në sjelljen e personazheve (nga filmat vizatimor dhe shfaqet e kukullave),” “ta vërejnë rolin arsimor dhe edukativ të këtyre filmave në kulturën e të jetuarit “...Por në të njëjtën lëndë, në një fushë tjetër programore “Shprehje dhe

11 Intervistë me arsimtaren për mësim klasor nga Shkupi, 03.11.2018 .

12 Intervistë me arsimtare të mësimin klasor nga Rajoni i Pollogut, 19.11.2018.

krijimtari” trajtohet kumtesa dhe lajmi si mjete komunikimi, me ç’rast bëhen ushtrime për hartimin, krahasimin dhe prezantimin e të njëjtave.

Në *klasën e tetë* të gjitha orët në Kulturën mediatike u janë të përkushtuara filmit dhe elementeve përcjellëse: skenar, personazhe, gjuha në film. Të gjitha përmbajtjet përsosën edhe në klasën e *nëntë* kur nga nxënësit pritet që ti dinë mjetet e shprehjes dhe nocionet në artin filmik: gjuha, grimi, aktrimi, muzika, efektet, maskat dhe ngjashëm.

“Me që nuk kam CD plejer, për temën filmi maqedonas, ju them nxënësve, në shtëpi në internet të gjejnë ndonjë film, ta sjellin dhe mandej ju tregoj filmat: “Nata e ujçërve”, “Mis Ston”, “Frosina”, e mandej ata më sjellin film me “Xheki Çen”. Kur do ti pyes përse nuk kanë sjellë, disa thonë se nuk kanë gjetur, ndërsa të tjerë se atë e kanë pasur të mërzitshme dhe e çuditshme ta dëgjojnë në gjuhën maqedonase. Këta nxënës janë gjeneratë tjetër, kërkojnë të mësojnë më shumë. Në lëndën tonë, Gjuha Maqedonase dhe letërsia, nuk kanë përmbajtje dhe letërsi, nuk ka përmbajtje digjitale dhe kjo nuk ka ndryshuar.”¹³

Arsimtarët ankohen e librave të pa azhurnuara në të gjitha gjuhët në të cilat realizohet mësimi.

Ashtu për shembull, në librin për gjuhë maqedonase për klasë të katërt, nxënësve u propozohet ushtrim për analizë të faqeve kryesore të gazetave “Shpic”, “Vreme”, “Dnevnik” e ngjashëm, të cilat nuk ekzistojnë disa vite me radhë.

Në grupin e fokusit në rajonin e Shkupit morri pjesë edhe Sonja Jovanovska, arsimtare e lëndës së gjuhës maqedonase nga klasa e gjashtë deri te e nënta.

“Librat janë të miratuara në vitin 2008. Unë dhe kolegët e tjerë bashkë-autorë, pasi që kaluan pesë vite pas miratimit, i reaguam BZHA se librat e mësimi duhet të revidohet, për shkak se i tërë programi mësimor duhet të evoluojë ashtu siç avancon shoqëria. BZHA nuk reagoi për vërejtjen tonë. Nënshkruam marrëveshje të re, kaluan pesë vite, ndërsa librat e mësimi nuk kanë ndryshuar.”¹⁴

Duket se më alarmante është gjendja me librat e mësimi për gjuhë dhe letërsi Turke, kështu që arsimtarët gjenden vetë:

“Punoj me nxënës të klasës së parë dhe ja, dy-tre vjet nuk kemi libra. Po, arsimtari do të përpiqet, por pas tre vitesh unë do të mbingarkohem, për të pesë orët sepse nuk ka libra shkollor as për Shkencat Natyrore, as për Shoqëri, as për Gjuhë, të kërkoj fletore pune për të gjitha punët nuk është fer. Nuk është njëjtë për të gjithë ata që kanë literaturë dhe

13 Arsimtari i lëndës Maqedonase dhe letërsi nga Manastiri, 20.11.2018.

14 Fragment nga deklarata e Sonja Jovanovskës, arsimtare e lëndës për gjuhë maqedonase dhe letërsi në grupin e fokusit në Shkup, të mbajtur më datën 02.11.2018.

për ato që nuk kemi. Për gjuhën turke nuk ka përkthim, tirazhet janë të vogla, nuk përkthen. Edhe ato që përkthehen janë me shumë gabime, dhe i korrigjojmë. Për “Kulturën mediatike” kemi 9 orë, ndërsa librat që janë shumë të vjetra, nuk ka pjesë për mediet.”¹⁵

Libra të freskuara shkollore janë të nevojshme edhe në mësimin për gjuhën shqipe.

Nëse mungojnë tekste, shtypja e të rejave stagnoi me reformat kur u aplikua arsimit fillor nëntëvjeçar. Nuk u bënë libra për të gjitha klasat. Ndërkaq “Kultura mediatike” në tekstet shkollore për gjuhën Shqipe sipas programit ekziston, për shembull, teatër, lajm, bibliotekë, film ... I ka këto përmbajtje, por është shumë pak, vetëm 3-4 fjali.”¹⁶

Edukimi qytetar. Lënda Edukimi qytetar, e cila mësohet si lëndë e obligueshme në klasën e tetë dhe të nëntë, është e përfaqësuar me një orë në javë, ndërsa ajo ishte një nga lëndët më të debatuar kur bëhet fjalë për reforma të sistemit arsimor nga viti 2016. Përpunimet e diskutueshme tematike të teksteve shkollore ishte arsyeja për tërheqjen e tyre nga mësimi, ndërsa ndryshimet në programin arsimor duket se u nisën në mënyrë më këmbëngulëse pikërisht nga kjo lëndë, si dhe programet për klasën e parë.¹⁷ Ministria e Arsimit dhe shkencës gjatë vitit 2017 dhe 2018, krijoi disa grupe pune të përbëra nga përfaqësues të disa institucioneve (MASH, BZHA, profesorë universitar, praktikantë) të cilët filluan të punojnë në azhurnimin e plan programeve për lëndët në periudhën e parë zhvillimore, si dhe për lëndën Shoqëria civile. Periudha e hulumtimit u përshtat me programin arsimor porsa të aprovuar për klasën e tetë, por ishim pa një libër mësimi dhe me njësi të pjesshme tematike, të cilat në formë të broshurave u dërguan mësuesve disa herë gjatë vitit shkollor.¹⁸ Arsimitarët trajnoheshin (trajnohen) gjatë gjysmë-vjetorit të parë.

“Sipas informacioneve nga kolegët këshilltarë për këtë lëndë, deri tani janë realizuar trajnime për aplikimin e programit mësimor për Edukimi qytetar. Më tepër se 400 arsimtarë e përcollën trajnimin, në të gjitha gjuhët mësimore në të cilat gjuhë mësimore në të cilat realizohet mësimi.”¹⁹

Në këtë lëndë, nga gjithsej gjashtë, mediet mësohen për një temë (të katërtën), të titulluar si “Religjioni, arti dhe mediet në shoqërinë qytetare”. Në gjashtë orët e rekomanduara për realizim të temës, për “mediet në shoqërinë demokratike” janë parashikuar vetëm dy orë në të cilat nxënësit pritet ti arrijnë rezultatet e mëposhtme: “ta

15 Intervistë të arsimtarë të lëndëve të gjuhës Turke nga Rajoni i Pollogut.

16 Arsimtar i lëndës për Gjuhës Shqipe dhe letërsi, Tetovë.

17 Reforma të mëdha në programet për klasë të parë në fillim të vitit 2018 paralajmëroi ministrja e atëhershme e arsimit dhe shkencës Renata Deskoska, Shpallje në ueb faqen e MASH: <http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-23-14-03-24/vesti-i-nastani/2231-golemi-promeni-vo-osnovoto-obrazovanie-novi-nastavni-planovi-i-programi-za-prvoodelencite>

18 Deri në fillim të dhjetorit të vitit 2018, u përgatitën tri broshura, të cilat në esencë janë tre temat nga libri i ri Edukimi qytetar. Të njëjtat janë të qasshme në ueb faqen e BZHA www.bro.gov.mk

19 Fragment nga intervista me Bllaga Paneva, këshilltare për gjuhë maqedonase dhe literaturë në BZHA.

dallojë rolin e medieve në krijimin e opinionit publik nëpërmjet shembujve konkretë”; “ti analizojë mundësitë për aplikimin e medias moderne në mjedisin e tyre (gazetë shkollore, radio shkollore, internet, portal, blog, video blog etj.) në drejtim të avancimit të vlerave qytetare.” Në mungesë të tekstit shkollor, BZHA ju rekomandon arsimtarëve literaturë dhe doracakë të cilat janë në përputhje me programin arsimor.²⁰

“Tema Medie është temë e fundit. Meqë libri për klasën e tetë është tërhequr, tani marrim broshura përmes Byrosë për zhvillimin e arsimit. Dhe fituam broshurë për temën. Por, personalisht konsideroj se këto koncepte të reja për Mësimin Qytetar janë të shkruara me një stil shumë të lartë, shumë janë teorike. E dyta nuk e dimë nëse tema Medie do ta ketë ose do të jetë në ndonjë formë tjetër. E treta, kjo temë përpunohet në prill, maj dhe nxënësit nuk janë aq shumë të interesuar për mësim kur vjen fundi i vitit shkollor. Dhe e katërta, konsideroj se kjo temë nuk është e përfaqësuar në mënyrë të mjaftueshme, ndërsa është rëndësishme, posaçërisht për shoqërinë tonë, që është shoqëri e pluralizmit dhe çdo kush duhet të ketë qëndrim të ndërtuar, të seleksionojë dhe të filtrojë informacione.”²¹

Por, edhe në atë propozim literaturë nuk ka libra dhe doracakë ekskluzivisht për mediet dhe rolin e tyre në krijimin e opinionit publik, e as për format e produksionit mediatic. Më afër me këtë është rekomandimi në *Praktikumin për integrim të mësimin multikulturor në arsimin për edukim fillor dhe të mesëm*²² në temën “Artikulli gazetaresk për komunitetet kulturore” të propozuar për lëndën Gjuhë amtare në klasën e nëntë.

Në edukimin qytetar për klasën e nëntë, në momentin e hulumtimit, në fuqi është programi që nga viti 2007, ndonëse ministria resorë e arsimit dhe shkencës paralajmëroi rishikim të programeve mësimore. Këtu ende vlen rekomandimi i BZHA për gjashtë orë për temën “Medie”, me çka nxënësit pritet ti arrijnë qëllimet vijuese: “të dallojnë lloje të ndryshme të medieve masive”; “ta shpjegojnë rolin e medieve në shoqërinë bashkëkohore”; “ti shpjegojnë karakteristikat e medieve masovike”; “ti dallojnë burimet e informacioneve dhe ta vlerësojnë cilësinë e tyre”; “ti kuptojnë pasojat nga informacioni i pasaktë”; “ta kuptojnë nevojën për kulturën mediatike”.

Punë me kompjuter dhe baza të programimit. Lënda Punë me kompjuterë dhe bazat e programimit sipas planit Mësimor të BZHA aplikohet në klasën e tretë, të katërt dhe të pestë, me dy orë në javë. Objektivat e mësimdhënies mbulojnë tri pjesë: shkencat kompjuterike, teknologjia informatike dhe shkrim-leximi digjital. Lënda është hartuar përmes shtatë temave të synuara për përfitimin e njohurive themelore, shkathtësive dhe kompetencave për shkrim-lexim kompjuterik dhe digjital.

20 Shih “Propozim lista e doracakëve për realizim të mësimin për lëndën Edukimi qytetar në klasën e tetë të arsimit nëntëvjeçar fillor në pajtim me temat nga programi arsimor, e qasshme në www.bro.gov.mk

21 Fragment nga intervista me arsimtarin për Edukimi qytetar nga Kumanova, data 31.10.2018 .

22 Link deri në Praktikumin për integrim të mësimin multikulturor në mësimin për arsim fillor dhe të mesëm <http://pmio.mk/wp-content/uploads/2017/02/Praktikum-za-integriranjena-na-multikulturnoto-ucenje-vo-nastavata-za-osnovno-i-sredno-obrazovanie.pdf>

Në programin për klasën e tretë, në temën e katërt “Onllajn jetë” me 12 orë të rekomanduara nga BZHA nxënësi/nxënësja duhet të “njihet me internetin si një mjet për marrje dhe shkëmbim të informacioneve/përmbajtjeve”, “të di të hap ueb faqe dhe të orientohet në atë”, “të di se si të lëviz nga një ueb faqe në tjetër, përkatësisht ti dallojë pozitat të cilat janë hiperlinqe”, “të di se si të gjejë informacion nga interneti për qëllimin përkatës, të seleksionojë dhe të ruajë përmbajtje”, “të aftësohet për gjetje dhe dëgjim të video përmbajtjeve në internet”, “ti dallojë pasojat nga shpërndarja e informacioneve private në internet”.

Në esencë përmes kësaj lënde, nxënësit mësojnë ti praktikojnë të tria komponentët e shkrim-leximit mediatic, e ato janë *qasje, analizë dhe prodhim* i përmbajtjes mediaticke në çfarë do qoftë forme.

Por duket se zbatimi i programit shkon me vështirësi, veçanërisht për shkak të pajimit të dobët teknik dhe kompjuterik të shkollave, gjë e cila shënohet si sfidë në Strategjinë e arsimit 2018-2025:

“...Shumica nga shkollat janë të pajisura në mënyrë të pakënaqshme me mjete ndihmëse për mësimin e lëndës, por edhe me TIK pajisje (për shembull LCD projektorë, smart-tabela e të tj.). Metodot bashkëkohore mësimore nuk aplikohet në mënyrë të mjaftueshme në praktikë. Ende nuk ekziston platformë elektronike arsimore për mësim.”²³

Këtë konstatim e ndajnë pothuajse të gjitha arsimtarët të cilët u konsultuan.

“Në ende i përdorim ato kompjuterët e vegjël. Por, ato janë aq të vjetërsuar, bateritë tanimë i kemi të djegura, kanë kapacitet aq të vogël të memories, që në orë më tepër kohë shpenzoj që të krijoj kushte teknike, se sa në mënyrë efektive të punoj me fëmijët.”²⁴

“Shkolla ende është me gropë septike, nuk ka kanalizim, ndërsa ku më internet të qëndrueshëm.”²⁵

“Gjendemi disi. Nëse nuk ka internet, i lëshojmë vetes përmes telefonave tanë “hot-spot” dhe punojmë onllajn. Shpesh herë ju them fëmijëve që vetë të kyçen në telefonat e tyre për të parë ndonjë video, edhe pse BZHA na thotë se telefonat celular nuk guxojnë të përdoren gjatë orës.”²⁶

Lënda Shkathtësi jetësore. Duket se me konceptin e shkrim-leximit mediatic është lënda për Shkathtësi jetësore, e cila si synim të përgjithshëm e ka “që të kontribuojë për jetën personale, emocionale dhe sociale të nxënësve, në atë mënyrë që e ndihmon zhvillimin e shkathtësive psiko-sociale, duke i aftësuar nxënësit për ballafaqim të suksesshëm me sfidat

23 “Strategjia e arsimit 2018-2025 dhe plani aksionar”, Ministria e arsimit dhe e shkencës, faq. 37

24 Deklaratë e arsimtarit klasor të gjuhës maqedonase, Veles, 27.11.2018 .

25 Deklaratë e arsimtarit klasor të gjuhës shqipe, Kumanovë, 31.10. 2018.

26 Deklaratë e arsimtarit klasor të gjuhës anglishte, Ohër, 26.11.2018 r.

e jetës së përditshme.” Programi mësimor përfshin tre periudha zhvillimore me nga tre orë. Në çdo periudhë realizohet Ora e kujdestarit të klasës, një herë në javë (ose gjithsej 36 orë).

Në plan-programin për klasën e parë deri në të tretë, në temën e tretë “Unë dhe të tjerët: marrëdhëniet shoqërore” në njësinë e përmbajtjes: “Zhvillimi i qëndrimit kritik ndaj medieeve”, midis qëllimeve të tjera për njohjen e llojeve të ndryshme të medieeve, programi është i orientuar që nxënësit “të kuptojnë se jo të gjitha informacionet janë të dedikuara për fëmijët, ...”, “aftësohen të dallojnë emisione/informacione të dobishme nga ato të pa dobishme” (programi nuk jep kategorizim se cilat janë të dobishme, ndërsa cilat emisione/informacione janë të padobishme v.jonë), por “pranon se ka emisione të dobishme dhe të padobishme”.

Edhe në periudhën e ardhshme zhvillimore, nga klasa e katërt deri në klasën e gjashtë, në të njëjtën temë, programi mësimor parashikon që nxënësi/nxënësja “të dijë për medie dhe emisione të cilat janë përkatëse për moshën e tij/saj”, “të aftësohet që konsultojë medie të ndryshme dhe të kërkojë informacione”, “të aftësohet të krahasojë informacione për të njëjtën ngjarje që janë marrë nga medie të ndryshme”, ... “të nxitet që ta shohë rëndësinë nga informimi i plotë dhe i gjithëmbarshtëm”.

Në periudhën e tretë të zhvillimit, nga klasa e shtatë deri në të nëntën, në të njëjtën temë dhe përmbajtje, ka qëllime mjaft ambicioze në programin mësimor. Nxënësit duhet “ti kuptojnë qëllimet dhe kufizimet e medieeve”, “të aftësohen që ti vënë informacionet në kontekstin e të drejtave të njeriut”, ... “të aftësohen që ti kontrollojnë informacionet që i marrin përmes medieeve”, “të aftësohen ta ndërtojnë qëndrimin e vet në bazë të informacioneve nga më tepër medie”, “të aftësohen ti shohin pasojat negative nga informacionet e caktuara në mediet” dhe “ti kuptojnë pasojat nga raportimi mediatik mbi njerëzit”.

Por në realitet, duket se programi i tillë fare nuk realizohet ose për arsye se Orari për bashkësinë e klasës më shpesh përdoret diskutimin e aktiviteteve në vazhdë e sipër, për problemet në klasën.

“Përvoja na tregon se të hënave kjo orë e parë, ose në përgjithësi e njohur si “orë e klasës”, jo rrallë përdoret për konstatimin e mungesave me ose pa arsye të nxënësve në javën paraprake ose për aktiviteteve të tjera rrjedhëse.”²⁷

Deklaratat janë se nuk kanë ndonjë libër të veçantë për këtë lëndë, ndërsa mësimi realizohet kryesisht përmes diskutimit. Megjithëse në programin mësimor thuhet se për çdo periudhë zhvillimore është përgatitur “doracak me shembuj të punëtorive prej ku mësuesit mund të tërheqin ide për realizimin e menjëhershëm të qëllimeve”, BZHA e propozon “Doracakun për mësim të lëndës zgjedhore” “Shkathtësi për jetë” (Çonteva, Zh., Koceva, S.)²⁸, në të cilin ka një temë të dedikuar “reklamave dhe reklamimit” me të cilin pritet që nxënësit të zhvillojnë “raport kritik ndaj reklamës”.

²⁷ Intervistë me Bllaga Paneva, këshilltare për gjuhë maqedonase në Byronë për zhvillim të arsimit.

²⁸ Ky doracak për lëndën Shkathtësi të të jetuarit, i cili në esencë është lëndë zgjedhore në klasë të shtatë, të tetë dhe të nëntë. Shih më tepër në <http://bro.gov.mk/?q=mk/priracnici-za-nastava-po-izbornite-predmeti>

Aktivitete të lira të nxënësve (seksion gazetaresk, i dramës...) Ministria e arsimit dhe shkencës ju ofron shkollave një formular për përgatitje të programit vjetor për punë, në bazë të të cilës secila shkollë mandej në mënyrë të pavarur do ta hartojë, ndërsa të njëjtin do ta miratojë Këshilli i shkollës dhe komuna²⁹. Ndër seksioneve të ndryshme që ofrohen (bibliotekistë të rinj, kulturë qytetare, gazetari, seksioni i dramës, teatër, shah etj. Duket se seksionet gazetareske dhe të dramës janë tërësisht të përshtatshme për mësim të bazave të gazetarisë dhe të fjalës publike. Zakonisht, këto seksione udhëhiqen nga arsimtarët e mësimin klasor, arsimtarët e lëndës së gjuhës Amtare dhe të letërsisë ose bibliotekistë. Rezultatet e suksesshme të këtyre seksioneve, të dukshme përmes publikimit të një gazete të nxënësve në forma të ndryshme (gazetë muri, gazeta e shtypur, onllajn faqe) ose organizimi i shfaqjeve teatrore, vizita në medie kështu ka të bëjë me entuziazmin e mësuesit.

“Ne kemi gazetë elektronike, “Veseli jabollçinja”. Jam krenare të them se punojmë me koleget në tre gjuhë: maqedonisht, turqisht, shqip, tanimë pesë vjet. Arsimtarët ju dërgojnë përmbajtje fëmijëve, pa marrë parasysh nëse ajo është ndonjë këngë ose vizatim. Fëmija nga Kirgistani dhe Serbia na dërgoi fotografi përmes meillit, e ne gëzohemi.”³⁰

“Para disa vitesh ne kishim bashkëpunim me Televizionin maqedonas, në emisionin “Zvon”. Shkonim atje tërë javën, mandej xhironim program të vitit të ri, ndërsa nxënësit shkuan edhe te teknika që të njihen me çdo gjë. Një grup i madh i nxënësve morri pjesë në atë vizitë. Mandej, ata vinin këtu, i xhironin nxënësit dhe ata mund të shihnin se si teknikisht bëhet xhirimi, zëri. Ky ishte program i planifikuar trevjeçar i shkollës në të cilin kishte nxënës nga të gjitha klasat me pika ritmike, kënd letrar, paraqitje skenike: e përgatitëm shfaqjen “Mishi i egër” nga Goran Stefanovski. Por ajo përfundoi. Tani nuk e bëjmë atë, nuk kemi financa. Por, ashtu mësohet për mediet.”³¹

Para rreth 10 vitesh për patronazhin e shkollës, drejtoresha me luti nëse mundem të bëj gazetë. Për tu shënuar për herë të parë jubileu i shkollës, shkrova dramë kushtuar emrit të patronit të shkollës. Ishte mjaft e mundimshme paralelisht të punoj, më mbaj mësim, të shkruaj tekst, të bej regji dhe të jem skenarist dhe skenograf e çdo gjë tjetër. Edhe prova me fëmijët. Është për të ardhur keq kur në arsimin pritet vetëm në entuziazmin, kur asgjë nuk paguhet. Entuziazmi shuhet kur shihni se të gjithë rreth jush kanë pagë të njëjtë, ndërsa ju keni më shumë punë.”³²

29 Shih më tepër në: <http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-24-06-34-40/pravilnici/194-pravilnik-forma-sodrzina-programa>

30 Arsimtar klasor nga Tetova, 19.12.2018.

31 Intervistë me arsimtaren e arsimit klasor nga Kumanova, 31.10.2018.

32 Arsimtar i lëndës për gjuhë Maqedonase dhe letërsi, Strumicë.

5.2. Si është e rregulluar edukimi i profesorëve për këtë fushë?

Konkluzë e përgjithshme e diskutimeve me mësuesit në arsimin fillor është se mungojnë trajnime të vazhdueshme për edukim mediatik, përkundër asaj se përsosja profesionale të kuadrit arsimor është e paraparë me Ligjin për arsim fillor. Kjo për shkak se teknologjia dhe mediet e reja janë materie e gjallë për të cilën mësuesit duhet të në jenë përputhje me mundësitë që i ofrojnë. Ngjashëm si në vendet e tjera, edhe edukatorët tanë e ndjejnë hendekun në dituritë dhe shkathtësitë që i posedojnë nxënësit dhe mësuesit (posaçërisht për shkrim-lexim kompjuterik dhe digjital), të përfituara më shpesh jashtë nga arsimit formal. Ajo kërkon metoda të reja të të mësuarit, bashkëkohore që do ta ndjekin jeten bashkëkohore onllajn.

“Në tërë prurjen e mjeteve, bombardimin me informacione, kam përshtypje se fëmijët harruan të dëgjojnë. Ata reagojnë vetëm në sensacione vizuale. Domethënë më ndodh që përderisa punojnë në kompjuter, unë i pyes, ju flas, ata nuk më regjistrojnë. ... Ne si arsimtarë patjetër duhet ti aftësojmë me shkathtësi për ti dalluar manipulimet, informacione të rreme, për atë se si të seleksionojnë informacione të sakta, të pasakta, të dëmshme nga ato të dobishme.”³³

Mësimdhënësit ende e kujtojnë trajnimin për shkrim-lexim mediatik që Instituti Maqedonas për Media (MIM) e realizoi në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit në periudhën 2009-2011. Por, përveç faktit se në këtë projekt ishin përfshirë 1.100 mësimdhënës për gjuhë amtare në arsimin fillor dhe të mesëm, u ofruan doracakë dhe onllajn resurse, duket se implementimi i këtyre përmbytjeve pushoi me përfundimin e projektit.

“Krahas shembullit pozitiv nga arsimtarët për përfshirje të përmbytjeve të ofruara në programet mësimore për gjuhën amtare, për fat të keq nuk arritëm ta bëjmë evaluimin e rezultateve nga projekti.”³⁴

Ndërkohë në kuadër të projektit për *Arsim të integruar ndëretnik* që e realizoi Ministria e arsimit dhe e shkencës me USAID-in, Qendra maqedonase për arsim qytetar dhe organizata të tjera joqeveritare të viteve 2011-2015³⁵, u realizuan trajnime për arsimtarë dhe nxënës për produktion mediatik.

NË këtë drejtim duhet të përmendet edhe përfshirja e Ministrisë së arsimit dhe shkencës si anëtare e Rrjetit për shkrim-lexim mediatik, të themeluar nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (AAASH) në vitin 2017. MASH ndërmjetësoi në shpërndarjen e DVD të titulluar “Informacione, video dhe dokumente të tjera për SHKRIM-LEXIMIN MEDIATIK”, në të cilin në një vend janë të siguruara materiale nga më të ndryshmet me ndihmën e të cilës arsimtarët në shkollat fillore të planifikojnë dhe të realizojnë orë për shkrim-lexim mediatik. BZHA dha mendim pozitiv për materialet që gjenden në DVD dhe e miratoi shpërndarjen nëpër shkollat.³⁶

33 Ibid.

34 Intervistë me Bllaga Paneva, këshilltare për gjuhë Maqedonase dhe letërsi në BZHA.

35 Shih më tepër në <http://mk.pmio.mk/archive/usaaid-interethnic-integration-in-education-project-iiep/>

36 Deklaratë nga Emilija Petreska Kamenjarova, udhëheqëse e departamentit për të drejta të njeriut dhe shkrim-lexim mediatik në AAASH

Në praktikë, arsimtarët, në mënyrë individuale ose në grup janë të përfshirë në aktivitete më të vogla ose më të mëdha projektuese për shkrim-lexim mediatik:

Në vitin 2014, me një organizatë joqeveritare norvegjeze, kishim trajnim pikërisht për mediet dhe se si ta atë ta punojmë. Ishte shumë interesante dhe më vjen keq që nuk kemi arritur atë ta zbatojmë. Qëllimin e kishim që ti mësojmë fëmijët të mendojnë me mendjen e tyre, ti nxisim të jenë kreativ dhe të hapur. Kemi probleme me fëmijët që të flasin hapur. Kanë problem të lexojnë lajm. Posaçërisht fëmijët nga klasa e nëntë, të cilët janë fëmijë të ndërtuar në moshën katërmëdhjetë vjeçare, të cilët, nëse ju besohet, kanë problem me leximin. Procesi i të menduarit ende nuk është i aktivizuar tek ta në mënyrën e duhur.”³⁷

Edhe në BZHA pranojnë nevojat e mësimdhënësve nuk janë të kënaqura. Një nga arsyet për atë është numri i zvogëluar i vizitave këshillëdhënëse profesionale nga këshilltarët nëpër shkollat.

“Deri para 2-3 vitesh kishim kontrolle të rregullta në shkollat. Mandej vijuan disa ndryshime ligjore pas së cilës vijoi periudhë e stagnacionin, e me atë u humb kontakti me atë që ndodh në terren.”³⁸

Prandaj është i nevojshëm planifikim në kohë dhe strategjik të vizitave këshilluese në shkollat, gjatë gjithë vitit shkollor, për tu siguruar një pasqyrë më reale e nevojave të mësimdhënësve.

Si e mësojnë arsimtarët shkrim-leximin mediatik?

Në programet studimore të fakulteteve pedagogjike në vend, mësohen segmente nga kultura mediatike, por më shpesh si përmbytje plotësuese në kuadër të një lënde të caktuar. Ashtu për shembull në fakultetin Pedagogjik pranë Universitetit “Klimenti i Ohrit” në Manastir ka disa programe studimore në të cilat tanimë ka më tepër lëndë të tilla. I tillë është për shembull programi studimor *Arsimtar për mësim klasor* ku një nga qëllimet në lëndën *Gjuhë maqedonase* (lëndë e obligueshme) është “Zhvillimi i raportit kritik ndaj medieve dhe zhvillim i kulturës gjuhësore”; në lëndën *Sociologjia e arsimit* (viti i parë) studentët njihen me “...rolin e arsimit në parandalimin dhe sanimin e sjelljes devijuese, si dhe ndikesa e medieve masive”, “Njohje e rolit të kompjuterëve dhe kompjuterizimi i arsimit si dhe përfitimet pozitive dhe pasojat nga e njëjta; në *Metodikën për arsimin në gjuhën maqedonase* është paraparë analizë e fushës programore Kulturë mediatike.” Në të njëjtin fakultet, në programin studimor *Pedagogji sociale dhe rehabilituese*, si lëndë zgjedhore në vitin e katërt ofrohet *Shkrim-leximi mediatik*.³⁹

37 Fragment nga deklarata e Sonja Jovanovskës, arsimtare e lëndës për gjuhën maqedonase dhe letërsi në grupin e fokusit në Shkup, të mbajtur më 02.11.2018 .

38 Intervistë me Bllaga Paneva, këshilltare për gjuhë Maqedonase dhe letërsi në BZHA.

39 Programe studimore në Fakultetin Pedagogjik pranë Universitetit “Klimenti i Ohrit, Manastir, http://www.pfbt.uklo.edu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=23&Itemid=147&lang=mk, për herë të fundit qasur më 11.11.2018.

Në fakultetin për shkencë arsimore pranë Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip, mediet mësohen në programin studimor *Mësim klasor*, në lëndën “Arsimi dhe kultura mediatike” e cila është lëndë zgjedhore në vitin e dytë.⁴⁰

Ajo që mbetet si çështje e hapur është se sa këto programe mësimore korrespondojnë me nevojat e fëmijës nga e a.q. “Zed Gjenerata” (Generation Z), e lindur në kohën e medieve të reja dhe të telefonave të mençur. Edhe arsimtarët, edhe një pjesë e profesorëve universitar pajtohen se programet studimore janë vetëm një pjesë e një “sistemi të ngurtë” që është rezistent ndaj ndryshimeve, ndërsa programet studimore janë vetëm një formalitet i zakonshëm.

“Modeste janë përvojat për angazhim të profesionistëve, praktikuesve si ligjërues të cilët do të mund të vlerësojnë. Ajo është mangësi ligjore (shembull: nuk mund të vlerësoni nëse nuk jeni doktor i shkencave). Këto programe shpesh herë janë vetëm një formalitet. Nuk mbahet llogari kush i ligjëron këto tema, çfarë është kompetenca e kuadrove, zgjedhja e literaturës e cila përdoret, lidhshmëria mes teorisë dhe praktikës, përkatësisht rezultatet përfundimtare. E tërë kjo shpien drejt një sistemi jo-efikas.

Nëse bëni analizë të planeve dhe programeve arsimore në Arsimin Fillor do të konstatohet se kultura mediatike është e përfaqësuar në mënyrë ndër-kulikulare, ajo përpunon disa tema nga aktrimi, të folurit, filmi, teatër, arte vizuale, prezantim të idesë filmike, sinopsis, dhe disi diku këtu çdo gjë përfundon, me diku 10 orë në klasën e 9-të, ndërsa në arsimin e mesëm edukimi mediatik madje nuk ekziston. Sa nxënësit pas përfundimit të arsimit të vet do të jenë me shkrim-lexim mediatik dhe të aftësuar për vlerësim të përmbajtjeve mediatike në esencë do të varet më së shumti nga arsimtarët, sa kohë dhe si e bëjnë atë. Por, parashtrahet pyetja a mund arsimtarët me këtë koncept të edukimit inicial t’ua transmetojnë atë nxënësve. Mendimi im është se nuk munden!”⁴¹

Vjetërsia e programeve studimore në fakultetet pedagogjike është e shënuar edhe në Strategjinë për arsim 2018-2025, kështu që një nga prioritetet (4.2.) të miratuara në Planin Aksionar është “Përmirësimi i Programeve Studimore (trajnim inicial) të arsimtarëve dhe të shërbimeve profesionale në pajtim me standardet profesionale”, ndërsa deri në vitin 2020 si indikator për sukses është “Programe të përmirësuar Studimore që janë të miratuara nga Këshilli për akreditim dhe evaluim i arsimit të lartë “. Gjithashtu parashihet revidimi i mënyrës së regjistrimit të studentëve në këto fakultete, përkatësisht parashihen rreth 500 bursa për nxënës me sukses më të mirë. Sipas të njëjtit dokument, Ministria e arsimit dhe e shkencës deri në vitin 2019 duhet të themelojë grup punues që do të bëjë rekomandime për revidimin e programeve të studimit.

40 Shih më tepër në <http://www.ugd.edu.mk/documents/studiski-programi/2017/1-ciklus/fon.pdf>

41 Deklaratë e Kiril Barbarev, profesor në Fakultetin për shkencë arsimore pranë Universitetit “Goce Dellçev” Shtip

Konkluz

Inkorporimi i shkrim-leximit mediatic në arsimin është praktikë e vendosur qëmtoi në botën dhe në Evropë. Fillimisht UNESCO, e mandej edhe Parlamenti Evropian përmes rezolutave dhe rekomandimeve të shumta si prioritet e theksojnë nevojën për mësimin e shkrim-leximit mediatic në të gjitha shkallët e edukimit dhe si pjesë e procesit e mësimin. Duke i përcjellë këto drejtime, sot pothuajse nuk ka vend evropian në të cilin në shkollat (fillore, të mesme, fakultetet) nuk mësohet vetëm përmes medie dhe me mediet (shtypi, radioja, televizioni, teatri, filmi, interneti) nxënësit të përfitojnë “kompetenca për qasje në përmbajtjet e ndryshme mediatic, aftësi për shpjegimin e tyre dhe vlerësim kritik, si dhe aftësi për krijimin vetanak të mesazheve mediaticke. Sot vëmendja është e orientuar në modalitetet e shkrim-leximit mediatic në programet ekzistuese edukative, përkatësisht nëse përmes programeve ekzistuese mësimore arrihen qëllimet e dëshiruara. Në atë drejtim, gjithnjë e më në numër të madh janë edhe hulumtimet jo vetëm për promovim të shkrim-leximit mediatic, por edhe për evaluim të kompetencave të fituara.

Njëri nga modelet më shpesh të aplikuara për mësimin e shkrim-leximit mediatic është qasja intern-kulturore, përkatësisht integrimi i plotë i saj në programin për gjuhë amtare, aspekte të caktuara në programet për lëndë të tjera, si dhe aktivitete të ndryshme jashtëshkollore (seksione për gazetari, gazeta shkollore). Model të tillë aplikon edhe Sllovenia, një vend që i pari në Evropën Qendrore dhe Lindore do ta zbatojë arsimimin mediatic në sistemin arsimor, nga arsimit parashkollor deri në atë të lartë. Në arsimin fillor “shkrim-leximi mediatic” realizohet përmes inkorporimit të tij në dy lëndë të obligueshme (gjuhë amtare, edukim qytetar dhe etikë), me njësi metodike në disa lëndë zgjedhore (shkrim-leximi kompjuterik, kompjuterë, dizajn artistik), si dhe për aktivitete të shumta jashtëshkollore (seksione, ligjërata, gazeta). Ajo që është specifike e këtij modeli është lënda zgjedhore “Edukimi për medie” i përbërë nga tre tërësi tematike – shtyp, radio, televizion dhe internet, program i përpunuar dhe libër mësimi në formë të shtypur. Kompetencat që nxënësit duhet ti arrijnë përmes lëndëve të obligueshme është pranim kritik dhe interpretimi i teksteve të ndryshme, zhvillimi i aftësive të komunikimit, ato kognitive dhe imagjinatave gjatë krijimit të teksteve të tyre, krijimi i kumtesave të shtypura dhe elektronike, kuptimi dhe vlerësimi i teksteve reklamuese, zhvillimi i shkrim-leximit politik, mendimi kritik për qëndrime dhe vlera të ndryshme dhe për përfshirje aktive në jetën shoqërore. Pothuajse të njëjtat kompetenca janë të përfaqësuara edhe në arsimin zgjedhor, me theks se nxënësit duhet të mësojnë që të kritikojnë në mënyrë kritike të analizojnë, vlerësojnë dhe krijojnë forma të ndryshme mediaticke, të jenë me shkrim-lexim për informacion dhe funksional, të jenë qytetarë aktiv e jo konsumues pasiv të mesazheve mediaticke.

Modeli aplikohet më tepër se 20 vjet, por nuk i jep rezultatet e pritura, posaçërisht në pjesën e arsimit zgjedhor. Prej këtu burojnë edhe kërkesat e publikut profesional dhe shkencor në Slloveni për inkorporim të shkrim-leximit mediatic në grupin e lëndëve të obligueshme me program të posaçëm, përkatësisht modernizimi i lëndës ekzistuese Edukimi për medie, e madje edhe definimi i tij i qartë si “shkrim-lexim”. Kjo është përcaktim strategjik edhe i shtetit dhe duhet të përfshijë jo vetëm nxënësit, por edhe të rriturit, botuesit, gazetarët, kreatorët dhe provajderët e onllajn shërbimeve. Por, fitimi i diturive dhe të shkathtësive për pranim kritik të informacioneve, vlerësimi

i tyre për formim kritik të informacioneve në raport me botën dhe shoqërinë përveç me shkrim-lexim mediatik, ndërlihet edhe me shkrim-lexim digjital. Madje në praktikën në dukje e sipër janë iniciativa për lëndë të veçantë “Shkrim-leximi digjital” i cili do ta kishte inkorporuar shkrim-leximin digjital e mediatik dhe mbrojtje të privatësisë dhe të dhënave personale. Koha do të tregojë nëse dhe çfarë ndryshime do të “arrijë” shkrim-leximi mediatik dhe edukimi mediatik.

Në Maqedoni deri para dhjetë vite shkrim-leximi mediatik ishte një gjë e panjohur. Për nga ana normative ajo edhe sot nuk është e definuar në mënyrë të qartë. Ligji për arsim fillor është ndryshuar shumë herë, ndërsa njëra nga ndryshimeve kyç është aplikimi i arsimit të obliguar nëntëvjeçar kur do të fillojnë reformat e planeve dhe të programeve arsimore. Pa marrë parasysh se një numër i madh i librave do të pësojnë revizion, ndërsa do të aplikohen edhe lëndë të reja të obligueshme dhe zgjedhore, sistemi arsimor nuk e “njohu” shkrim-leximin mediatik si pjesë përbërëse të programeve për arsim fillor. Përballë kësaj, në mënyrë strategjike (Ministria e arsimit dhe e shkencës) që moti (nga viti 2005) është shënuar se sa është me rëndësi “shkrim-leximi kompjuterik” të rinjve dhe të rriturve dhe se ajo është bazë për përgatitje efikase të fëmijëve/të rinjve për zhvillim të aftësive për mendim të pavarur krijues dhe kritik dhe krijim të shoqërisë inkluzive informatike për të gjithë qytetarët. Sot, ndërkaq, vëmendja është e orientuar, para së gjithash në nevojën për intensifikim i TIK (Teknikave Informatike dhe të Komunikimit) në edukimin përmes portalit për e-mësim dhe sistem për menaxhim me mësimin dhe trajnim të vazhdueshëm të kuadrit për shfrytëzim të teknologjive të reja dhe TIK mjete në arsimin. Jo rrallë përdorimi i medieve të reja në mësimin njësohet me shkrim-leximin mediatik: mësimi me mediet, nuk do të thotë se është njëllojti edhe mësim për mediet.

Mbetet e hapur çështja kur dhe si shkrim-leximi mediatik do të inkorporohet në sistemin arsimor, posaçërisht në arsimin fillor. Ajo që nxënësit e shkollave fillore do të duhej ta mësojnë për shkrim-leximin mediatik, deri tani është absolvuar me “vendosje” të sferave të caktuara programore në lëndët e ndryshme të cilat mbulojnë vetëm pjesë të kësaj fushe. Por, jo si shkrim-leximi mediatik, por si “kulturë mediatike”, “shprehje dhe krijim”, ose si tema të veçanta në një lëndë konkrete, si “onllajn jetë”, “medie”, “familje, amvisëri dhe shoqëri”. Nxënësit njihen me lloje të ndryshme të medieve, shtyp, radio, televizion, film, teatër, internet. Ata lexojnë revista, përcjellin emisione në radio dhe televizion, shohin shfaqe teatrore, i rrëfejnë dhe bisedojnë për atë që e kanë lexuar, dëgjuar ose që e kanë parë, hartojnë kumtesa, lajme, shkrime gazetarske, intervista, kërkojnë dhe seleksionojnë informacione në internet. Por, koha është e shkurtër për tu arritur qëllime ambicioze: aftësim dhe nxitje e interesit për përcjellje të medieve të ndryshme, analizimi i përmbajtjes së tyre dhe marrje të qëndrimit të vet për cilësinë e informacioneve të ndryshme. Vetëm 5-7% nga arsimi përfshin tema në të cilat duhet ta nxisin raportin kritik ndaj medieve. Arsimtarët “e ngarkuar” që fëmijëve t’ua transmetojmë këto përmbajtje janë ata që e ligjërojnë gjuhën amtare, shoqërinë, punë me kompjuterë dhe baza të programimit. E pa kontestueshme është nevoja për modernizimin e kushteve të punës (mediateka, mjete për prodhim mediatik). Mungon rumbullakësim i kuadrit arsimor i cili duhet të jetë me shkrim-lexim të mjaftueshëm mediatik që t’ua transmetojë kompetencat e veta filloristëve të sotëm, të cilët edhe nuk e mbajnë në mend njëjtën para telefonave të mençur ose e a.q. “gjeneratë ZET”.

Rekomandime

Sistemi bashkëkohor arsimor në mënyrë të pashmangshme e përshin shkrim-leximin mediatik në të gjitha nivelet – nga arsimit parashkollor deri te ai i lartë. Ky është një koncept i cili përmirësohet në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, në përputhje me zhvillimin e medieve të reja dhe formave të shprehjes. Nga aspekti i përfshirjes së shkrim-leximit mediatik në sistemin arsimor në Maqedoni, i cili përballet me sfida të shumta dhe procese reformuese, përfundohet një përfundim i qartë se kjo sferë është e përfaqësuar në mënyrë të mjaftueshme. Nevoja për avancim urgjent të kësaj fushë në arsimin fillor është një domosdoshmëri e detektuar jo vetëm nga arsimtarët, por edhe nga ekipi kërkimor që i analizoi planet dhe programet arsimore. Bazuar në gjetjet e përfituara nga hulumtimi i Shkollës së lartë për gazetari dhe marrëdhënie me opinionin, vijojnë këto rekomandimet:

Rekomandime të përgjithshme:

- Harmonizimi i legjislativit, strategjive dhe planeve në politikën arsimore për zhvillim të shkrim-leximit mediatik në pajtim me standardet evropiane dhe rekomandimet në këtë sferë.
- Avancimi i bashkëpunimit midis të gjithë faktorëve në shoqërinë me qëllim të promovimit më të madh të shkrim-leximit mediatik: zhvillimi i dialogut midis institucioneve arsimore dhe të tjera kompetente, prindërit, sektorit civil, mediet, industrinë mediatike dhe Agjencinë për shërbime audio dhe audiovizuale.

Rekomandim Ministrisë për arsim dhe shkencë, Byrosë për zhvillim të arsimit dhe institucione të tjera kompetente për politikë arsimore:

- Aplikimi i konceptit të shkrim-leximit mediatik në procesin arsimor si model interkulikular të arsimit mediatik. Dizajnim, planifikim dhe realizim të programit për shkrim-lexim mediatik në arsimin fillor qëllimi i të cilit do të jenë komplementare me tri elementet themelore të këtij koncepti: *qasje, analizë dhe produktion* të përmbajtjeve mediatike në të gjitha format e mundshme.
- Revizion i planeve dhe programeve ekzistuese në arsimin fillor me përfshirje të temave që kanë për qëllim që ta nxisin pranimin dhe analizën kritike të përmbajtjeve mediatike, posaçërisht të atyre në të cilat janë të ekspozuar nxënësit – mediet e reja dhe rrjetet sociale. Aftësimi i nxënësve me shkathtësi dhe dituri për prodhim mediatik dhe shfrytëzim të avantazheve të medieve për artikulum të interesave të tyre si qytetarë aktiv në shoqërinë.
- Zhvillimi i politikës për trajnime të vazhdueshme, programe për zhvillim profesional dhe edukim të kuadrit arsimor për shkrim-lexim mediatik. Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të angazhimit të arsimtarëve në aktivitetet me të cilat nxitet shkrim-leximi mediatik tek nxënësit (udhëheqje me seksionet gazetareske, dramatike dhe të ngjashme, përgatitje dhe kultivimi i gazetës shkollë - të shtypur ose onlajn, organizimi i aktiviteteve dramatike dhe teatrore etj..).
- Modernizimi i literaturës që shfrytëzohet në arsimin me tema për shkrim-lexim mediatik: revidimi i librave të mësimi – bë të gjitha gjuhët në të cilat realizohet mësimi – në të cilat trajtohet roli i medieve në jetën bashkëkohore dhe pasurimi i mjeteve ndihmëse didaktike për arsimtarët në këtë fushë (doracakë, praktikumë dhe ngj.).
- Angazhim më i madh nga Byroja për zhvillim të arsimit në përcjelljen implemen-

timin e programeve mësimore, me qëllim të përcaktimit në kohë të nevojave të kuadrove arsimore dhe të nxënësve, posaçërisht për temat të cilat kanë për qëllim ta avancojnë shkrim-leximin mediatik te nxënësit.

Rekomandim për fakultetet pedagogjike

- Revidim i studimeve programore të fakulteteve pedagogjike me programe bashkëkohore arsimore për shkrim-lexim mediatik. Përforcimi i cilësisë së kuadrit arsimor i cili i ligjëron këto përmbajtje.
- Avancimi i bashkëpunimit me mediet dhe organizatat mediatike për përfshirje të praktikuesve në fushën e gazetarisë dhe të komunikimeve në arsimin akademik.

Bibliografi

Aufderheide, P. (1993), Media Literacy - A Report of The National Leadership Conference on Media Literacy , The Aspen Institute, Washington D.C. Available at: <http://files.eric.ed.gov/fulltext/ED365294.pdf>

Buckingham, David (2001). Media Education. A Global Strategi for Development. A Policy Paper Prepared for UNESCO, Sector of Communication and Information: UNESCO

Bachmair, Ben, Bazalgette, Cary (2007) The European Charter for Media Literacy: meaning and potential, Research in Comparative and International Education, Volume 2, Number 1, Available at: https://www.researchgate.net/publication/250152397_The_European_Charter_for_Media_Literacy_Meaning_and_Potential

Bulger Monica and Davison Patrick (2018) The Promises, Challenges, and Futures of Media Literacy, Data & Society Research Institute, Available at: https://datasociety.net/pubs/oh/DataAndSociety_Media_Literacy_2018.pdf

Camody Hagood, Margaret (2011) Media Literacy Education: On the Move, The National Association for Media Literacy Education's Journal of Media Literacy Education 3:1 (2011) 11–13, Available at: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ985659.pdf>

Ding, Suzsanne (2011) The European Commission's Approach Media Literacy, in Media literacy: Ambitions, policies and measures (edt. Sonia Livingstone), COST Action 'Transforming Audiences, Transforming Societies' , Available at: http://www.cost-transforming-audiences.eu/system/files/cost_media_literacy_report.pdf

Drotner, Kristen (2014) Media and Information Literacy Policies in Denmark, DREAM and Institute for the Study of Culture – Media Studies, University of Southern Denmark, Denmark, Available at: http://ppemi.ens-cachan.fr/data/media/colloque140528/rapports/DENMARK_2014.pdf

Druick, Zoë, The Myth of Media Literacy, International Journal of Communication 10(2016), Available at: <https://ijoc.org/index.php/ijoc/article/viewFile/2797/1583>

EAVI - Study on Assessment Criteria for Media Literacy Levels,(edt. Paolo Celot), Brussels 2009, Available at: <https://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/mars/source/resources/references/others/37%20-%20Media%20Literacy%20Evaluation%20Criteria%20Europe%20EU%202009.pdf>

Educating for the Media and the Digital Age, International Conference in Vienna, 1999, (ed. Fiona Gundacker, Koordinationsbüro Gudrun Waltenstorfer) , Vienna In co-operation with UNESCO, Available at: https://www.mediamanual.at/en/pdf/educating_media_engl.pdf

Empowerment through Media Education – An Intercultural dialogue, (eds. Ulla Carlsson, Samy Tayie, Geneviève Jacquinot-Delaunay and José Manuel Pérez Tornero),

The International Clearinghouse on Children, Youth and Media, 2008, NORDICOM at Göteborg University, Available at: http://www.mediamentor.org/files/attachments/Empowerment_Through_Media_Education.pdf

Global Media and Information Literacy Assessment Framework: Country Readiness and Competencies (ed. Peter Coles), UNESCO 2013, Paris, France, Available at: http://www.karsenti.ca/archives/UNE2013_01_MIL_FullLayout_FINAL.PDF

Livingstone, Sonia (2004), Media Literacy and the Challenge of New Information and Communication Technologies, *The Communication Review*, 7:3–14, 2004, Taylor & Francis Inc. , Available at: http://net-workingworlds.weebly.com/uploads/1/5/1/5/15155460/ml_challenges_livingstone.pdf

Hartai, László (2014), Report of Formal Media Education in Europe (WP3), EMEDUS, European Media Literacy Education Study, Available at: <https://eavi.eu/wp-content/uploads/2017/02/Media-Education-in-European-Schools-2.pdf>

Wan, G. & Gut, D. (2008). Roles of media and media literacy education: Lives of Chinese and American adolescents. *New Horizons in Education*, 56 (2), 28-42. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ832904.pdf>

Wilson, C. Grizzle, A. Tuazon, Kwame, R. Chi-Kim Cheung, A. Media and Information Literacy Curriculum for Teachers (2011), UNESCO, Paris, France, Available at: <http://unesdoc.unesco.org/images/0019/001929/192971e.pdf>

Iva Junová, Iva (2016) Media education in primary schools in the Czech Republic, SHS Web of Conferences, ERPA 2015, Available at: https://www.shs-conferences.org/articles/shsconf/pdf/2016/04/shsconf_erp2016_01092.pdf

Kupiainen, Reijo & Sintonen, Sara (2010) Media Literacy as a Focal Practice, in *Media Literacy Education - Nordic Perspectives* (eds. Sirkku Kotilainen & Sol-Britt Arnolds-Granlund), 2010, Nordicom, University of Gothenburg, Available at: http://www.nordicom.gu.se/sites/default/files/publikationer-hela-pdf/media_literacy_education_0.pdf

Mapping Media Education Policies in the World - Visions, Programmes and Challenges (Editors: Divina Frau-Meigs and Jordi Torrent), The United Nations-Alliance of Civilizations in co-operation with Grupo Comunicar, UNESCO, European Commission (2009), Available at: https://www.unaoc.org/images/mapping_media_education_book_final_version.pdf

Mapping of media literacy practices and actions in EU-28, (edt. Francisco Javier, Cabrera Blázquez, Sophie Valais) European Audiovisual Observatory, Strasbourg 2016, Available at: <https://rm.coe.int/media-literacy-mapping-report-en-final-pdf/1680783500>

Media literacy in Europe – Contraversies, challenges and perspectives, (edt. Patrick Verniers), Euro Meduc 2009, Bruxelles, Available at: https://euromeduc.eu/IMG/pdf/Euromeduc_ENG.pdf

Media education (1984), UNESCO (ed. Zaghoul Morsy), Paris, Available at: <http://unesdoc.unesco.org/images/0006/000625/062522eo.pdf>

Media education in four EU countries - Common Problems and Possible Solutions (2013), My Child Online Foundation and the Kennisnet Foundation (edt. Henk Boeke), Available at: https://www.mediawijzer.net/wp-content/uploads/sites/6/2013/10/rapport_media_onderwijs_EU.pdf

Media Literacy Education - Nordic Perspectives (eds. Sirkku Kotilainen & Sol-Britt Arnolds-Granlund), 2010, Nordicom, University of Gothenburg, Available at: http://www.nordicom.gu.se/sites/default/files/publikationer-hela-pdf/media_literacy_education_0.pdf

Media and Information Literacy for the Sustainable Development (eds. Jagtar Singh, Alton Grizzle, Sin Joan Yee, Sherri Hope Culver), The International Clearinghouse on Children, Youth and Media, 2015, NORDICOM at Göteborg University, Available at: http://www.nordicom.gu.se/sites/default/files/publikationer-hela-pdf/milid_yearbook_2015.pdf

Media Literacy and Education Needs of Journalists and the Public in Albania, BosniaHerzegovina, Macedonia, Montenegro, Serbia - Regional Report, 2017, Available at: http://www.mediacentrbg.org/wp-content/uploads/2017/05/Media-Literacy-and-Education-Needs-of-Journalists-and-the-Public_REPORT_FINAL.pdf

Medijska pismenost – preduvjet za odgovorne medija (2015), Fakultet politickih nauka Univerziteta u Sarajevu,(ur. Viktorija Car, Lejla Turcilo, Mirjana Matovic), Available at: http://www.hanns-seidel-stiftung.com.hr/images/seminari/2015/fpzg_mediji/medijska_pismenost.pdf

Medijska pismenost Slovenija 2014, Fakulteta za medije, Ljbljana, Available at: http://www.pismenost.si/pdf/Raziskava_MP_Slovenija_2014.pdf

Buckingham, D. (2003) Media Education: education, learning and contemporary culture, Polity Press, Cambridge, UK

Hobbs, R. (2011). Digital and Media Literacy – Connecting Culture and Classroom, Corvin

Oxstrand, Barbaro (2009). Media literacy education - A discussion about media education in the western countries, Europe and Sweden. Paper presented at the Nordmedia09 conference in Karlstad University, Sweden, , Available at: https://gupea.ub.gu.se/bitstream/2077/22007/1/gupea_2077_22007_1.pdf

Peicheva, Dobrinka, Milenkova, Valentina (2016) Media Education Policy in Bulgaria, Journal on Efficiency and Responsibility in Education and Science, Vol. 9, No. 1, pp. 7-16, Available at: <http://oaji.net/articles/2016/2466-1462764572.pdf>

Perez Tornero, Tapio Varis (2010), Media Literacy and New Humanism, UNESCO Institute for Information Technologies in Education, Moscow, Russian Federation, Available at: <http://unesdoc.unesco.org/images/0019/001921/192134e.pdf>

Potter, J. W. (2013b), Media Literacy, University of California, Santa Barbara, 7th Edition

Recepoğlu, Ergün (2015), The importance of media literacy education in the process of teacher training in higher education, The International of Social Sciences, Vol.40, NO.1, Available at: <https://www.tijoss.com/TIJOSS%2040th%20Volume/1ergun.pdf>

Tanriverdi, Belgin, Apak, Özlem (2010) Analysis of Primary School Curriculum of Turkey, Finland, and Ireland in Terms of Media Literacy Education, Educational Sciences: Theory & Practice, Available at: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ889203.pdf>

Thoman, Elizabeth, Jolls, Tessa Jolls (2003) Literacy for the 21st Century, An Overview & Orientation Guide To Media Literacy Education, Center for Media Literacy, Available at: http://www.medialit.org/sites/default/files/01_MLKorientation.pdf

Thoman Elisabeth, (1990) UNESCO Convenes International Media Literacy Conference in Toulouse, Available at: <http://www.medialit.org/reading-room/unesco-convenes-international-media-literacy-conference-toulouse>

Worsnop, C., Media literacy through critical thinking available at: https://depts.washington.edu/nwmedia/sections/nw_center/curriculum_docs/stud_combine.pdf

ЗАКОНИ, ДОКУМЕНТИ, РЕЗОЛУЦИИ, ПРЕПОРАКИ

Grunwald Declaration on Media Education, Grunwald, Federal Republic of Germany, 22 January 1982, Available at: http://www.unesco.org/education/pdf/MEDIA_E.PDF

Council of Europe: Recommendation 1466 (2000) Media Education, Available at: <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=16811&lang=en>

European Commission, EUROPE 2020 A European strategy for smart, sustainable and inclusive growth, Available at: <http://ec.europa.eu/eu2020/pdf/COMPLET%20EN%20BARROSO%20%20%20007%20-%20Europe%202020%20-%20EN%20version.pdf>

European Commission, Recommendation on media literacy in the digital environment for a more competitive audiovisual and content industry and an inclusive knowledge society, (2009/625/EC), Available at: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32009H0625>

European Commission, A European approach to media literacy in the digital environment, COM (2007) 833, Available at: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM%3A2007%3A0833%3AFIN%3AEN%3APDF>

European Parliament, Recommendation on the protection of minors and human dignity and on the right of reply in relation to the competitiveness of the European audiovisual and on-line information services industry, 2006, Available at: <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&f=ST%209577%202006%20REV%201>

European Union, Council for Education, Youth, Culture and Sports (2016), Conclusion on developing media literacy and critical thinking through education and training, Available at: <http://www.eunec.eu/sites/www.eunec.eu/files/attachment/files/conclusions.pdf>

Paris agenda or 12 Recommendations for Media Education, Available at: https://www.diplomatie.gouv.fr/IMG/pdf/Parisagendafin_en.pdf

Parliamentary Assembly, Recommendation 14466(2000), Media Education, Available at: <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=16811&lang=en>

Recommendations addressed to UNESCO Adopted by the Vienna Conference „Educating for the Media and the Digital Age“, 1999, Available at: <http://www.nordicom.gu.se/en/clearinghouse/recommendations-addressed-unesco-media-education>

Strategija razvoja medijev v Republiki Sloveniji do leta 2024, Ministrstvo za kulturo Republike Slovenije junij 2016, Available at: http://www.mk.gov.si/fileadmin/mk.gov.si/pageuploads/Ministrstvo/Fotogalerija/2016/junij/MED-STRATstrategija_razvoja_medijev_v_Republiki_Sloveniji_do_leta_2024_-_v_1.0_junij_2016.pdf

UNESCO (2014), Paris Declaration, The right of access to information, independent media, and safety for exercising freedom of expression, are essential to development, Available at: https://en.unesco.org/sites/default/files/wpfd_2014_statement_final.pdf

UNESCO (1999) Recommendations adopted by the Vienna Conference “Educating for the Media and the Digital Age”, Available at: <https://www.mediamanual.at/en/pdf/recommendations.pdf>

UNESCO-Teacher training. (2008b). Teacher Training Curricula for Media and Information Literacy. Retrieved 12th of March, 2009, Available at: http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CI/CI/pdf/teacher_training_curricula_mil_meeting_june_2008_report_en.pdf

Plani arsimor për arsim fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2018-2019, BRO, në dispozicion në: http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastaven_plan/Resenie_za_dopolnuvanje_nastaven_plan_devetgodishno_2018.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të I-rë në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në: http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastavni_programi/i_odd_nastavna_programa_MK-ALB.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të II-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastavni_programi/II_odd_nastavna_programa_MK-ALB.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të III-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastavni_programi/III_odd_nastavna_programa_MK-ALB.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të IV-ërt në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/4_nastavni_programi.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të V-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastavni_programi/V-oddelenie/V_oddelenie_programi.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të VI-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastavni_programi/Nastavni_programi_VI.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të VII-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/6odd/nastavni%20programi/makedonski_jazik.pdf

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të VIII-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:<http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/VII%20oddelenie/Microsoft%20Word%20-%20makedonski%20jazik.pdf>

Program arsimor për gjuhën Maqedonase për klasë të IX-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/makedonski_jazik.pdf

Programi arsimor për Shoqëri për klasën e IV-ërt në mësimin nëntëvjeçar fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastavni_programi/IV-oddelenie/Nastavna_programa-Opshtestvo-IV_oddelenie.pdf

Programi arsimor për Punë me kompjuterë dhe baza të programimit për klasë të IV-ërt në mësimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në:http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/nastavni_programi/IV-oddelenie/Nastavna%20programa-Rabota%20so%20kompjuter%20i%20osnovi%20na%20programiranjeto-IV%20odd.pdf

Programi arsimor për Shoqëri qytetare për klasë të IXç-të në mësimin fillor nëntëvjeçar, Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në: http://bro.gov.mk/docs/gragjansko_obrazovanie.pdf

Praktikum për integrim të mësimi multikulturor në mësimin për arsim fillor dhe të mesëm: <http://pmio.mk/wp-content/uploads/2017/02/Praktikum-za-integriranjena-na-multikulturnoto-ucenje-vo-nastavata-za-osnovno-i-sredno-obrazovanie.pdf>

Doracak për klasë të IV-ërt në mësimin fillor nëntëvjeçar, (2017), Byroja për zhvillim të arsimit, në dispozicion në: <http://bro.gov.mk/docs/prirachnici/Prirachnik%20po%20opshtestvo%20za%20IV.pdf>

Strategjia për arsim për vitin 2018-2025 dhe Plani aksionar, Republika e Maqedonisë, në dispozicion në: <http://mrk.mk/wp-content/uploads/2018/10/Strategjia-za-obrazovanie-MAK-WEB.pdf>

Ligji për arsimin fillor, Gazeta zartare e Republikës së Maqedonisë, nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015 dhe 145/2015.

Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 184, 26.12.2013.

Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 13, 23.01.2014.

Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 44, 05.03.2014.

Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 101, 07.07.2014.



SHKRUVAJ ZASHAM FOL FÇQISHAM



ВИСОКА ШКОЛА ЗА НОВИНАРСТВО
И ЗА ОДНОСИ СО ЈАВНОСТА

новина
Македонија



MEDIA DIVERSITY
INSTITUTE

www.vs.edu.mk